Doracak për anëtarët e Kuvendit të Komunës

Shtator 2016

Tabela e përmbajtjes

Hyrje: Qëllimi dhe struktura e doracakut 7

Kapitulli I - Korniza ligjore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë 8

Kapitulli II - Demokracia lokale 10

1. Kuvendi i Komunës 10

1.1 Komitetet e Kuvendit të Komunës 10

1.2 Grupet e anëtarëve në Kuvendin e Komunës 14

Roli i anëtarit të Kuvendit të Komunës 16

1.3 Kuvendi i Komunës dhe këshillat e fshatrave 17

Roli i anëtarit të Kuvendit të Komunës 18

1.4 Komunikimi me publikun 18

1.5 Demokracia e drejtpërdrejtë 19

Kapitulli III - Financat komunale 23

1. Rolet e institucioneve në menaxhimin e financave komunale 23

1.1 Institucionet komunale 23

1.2 Institucionet qendrore 25

2. Burimet e financimit të komunave 26

2.1 Të hyrat vetanake të komunave 26

2.2 Grantet operative 29

2.2.1 Granti për shëndetësi parësore 29

2.2.2 Granti për arsim parauniversitar 29

2.2.3 Granti i përgjithshëm 29

2.3 Burimet e tjera të financimit 30

3. Procesi i planifikimit të buxhetit komunal 31

3.1 Përfshirja e Kuvendit të Komunës në planifikimin e buxhetit komunal 33

3.2 Dokumentet komunale të cilat duhet të trajtohen gjatë planifikimit të buxhetit 35

4. Buxhetimi i targetuar, me pjesëmarrje dhe transparent 35

4.1 Buxhetimi i targetuar 35

4.2 Buxhetimi me pjesëmarrje 36

4.3 Buxhetimi transparent 37

5. Prokurimi 37

5.1 Institucionet rregullative 37

5.2 Procesi i prokurimit 38

5.3 Procedurat për parashtrimin e ankesave 39

5.4 Llojet e procedurave të prokurimit 40

5.5 Plani i rrjedhës së parasë 41

6. Monitorimi dhe mbikëqyrja e buxhetit komunal 42
6.1 Roli i Kuvendit të Komunës në mbikëqyrjen e buxhetit 42
7. Auditimi 46
7.1 Auditimi i brendshëm 46
7.2 Auditimi i jashtëm 47
7.2.1 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm 47
7.2.2 Përkufizimi i auditimit të jashtëm 47
7.3 Përshkrimi i punës në grupe 50
Kapitulli IV - Komiteti për Shërbime Publike 52
1. Komiteti për Shërbime Publike 52
1.1 Pse të themelohet ky komitet 52
1.2 Funksionimi i Komitetit për Shërbime Publike 53
1.3 Roli i Komitetit për Shërbime Publike 53
1.4 Përshkrimi i punës në grupe 57

Tabela e figurave

Figura 1: Zinxhiri i llogaridhënies në komunë 9
Figura 2: Kategoritë e komiteteve të Kuvendit të Komunës 10
Figura 3: Rolet e institucioneve komunale në përpilimin e buxhetit komunal 23
Figura 4: Rolet e institucioneve komunale në implementimin e buxhetit komunal 24
Figura 5: Rolet e institucioneve komunale në mbikëqyrjen e financave komunale 24
Figura 6: Procesi i planifikimit të buxhetit komunal 31
Figura 7: Hapat që duhen ndërmarrë gjatë planifikimit të buxhetit komunal 32
Figura 8: Përfshirja e Kuvendit të Komunës në procesin e buxhetimit 33
Figura 9: Përmbajtja e dokumenteve të planifikimit të buxhetit komunal 34
Figura 10: Dokumentet që duhet të trajtohen gjatë planifikimit të buxhetit komunal 35
Figura 11: Procesi i prokurimit në Kosovë 39
Figura 12: Roli i Kuvendit të Komunës në monitorimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit komunal 42
Figura 13: Përmbajtja e raporteve tremujore financiare 43
Figura 14: Cikli i auditimit të brendshëm dhe roli i Kuvendit të Komunës 46
Figura 15: Fushat e angazhimit të Komitetit për Shërbime Publike 54
Figura 16: Dokumentet të cilat duhet të shqyrtohen nga Komiteti për Shërbime Publike dhe partnerët potencialë të tij 56

Hyrje: Qëllimi dhe struktura e doracakut

Qëllimi i këtij doracaku është të ofrojë një përmbledhje të informatave për anëtarët e kuvendeve të komunave mbi çështje të ndryshme që lidhen me punën dhe angazhimin e tyre në këtë post. Struktura dhe përmbajtja e doracakut janë përpiluar duke u bazuar në një hulumtim paraprak, i cili ka pasur për qëllim identifikimin e nevojave të anëtarëve të kuvendeve për ngritje të kapaciteteve rreth temave të ndryshme nga fusha e menaxhimit të financave komunale. Hulumtimi ka përfshirë intervista me kryetarët dhe anëtarët e komiteteve për politikë dhe financa (gjatë periudhës 17 nëntor – 7 dhjetor 2014) të 17 komunave të Kosovës.

Megjithatë, ky doracak është i dobishëm për të gjithë të interesuarit rreth temave që kanë të bëjnë me kompetencat dhe detyrat e kuvendeve të komunës dhe të anëtarëve të tyre.

Ky doracak është i ndarë në katër kapituj të veçantë.

Në Kapitullin e I-rë trajtohet korniza ligjore mbi vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës, duke filluar nga kushtetuta e vendit e deri te aktet nënligjore më të rëndësishme për funksionimin e vetëqeverisjes lokale në vend.

Në Kapitullin e II-të trajtohet demokracia lokale, në kuadër të së cilës shkurtimisht shpjegohet funksionimi i Kuvendit të Komunës dhe më tej vëmendje e posaçme i kushtohet themelimit dhe funksionimit të komiteteve të Kuvendit të Komunës, funksionimit të grupeve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, bashkëpunimit të Kuvendit të Komunës me këshillat e fshatrave, komunikimin e Kuvendit të Komunës me publikun, si dhe trajtohen elementet e demokracisë së drejtpërdrejtë në komuna.

Në Kapitullin e III-të trajtohet tema e financave të pushtetit lokal. Në kuadër të këtij kapitulli, vëmendje e posaçme i kushtohet prezantimit të roleve dhe përgjegjësive të institucioneve në procesin e buxhetimit, burimeve të financimit komunal, procesit të planifikimit të buxhetit komunal, buxhetimit transparent, prokurimit, mbikëqyrjes së realizimit të buxhetit komunal, si dhe auditimit.

Në Kapitullin e IV-të jepet një pasqyrë e përgjithshme mbi funksionimin e komitetit për shërbime publike të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë prezantimin e nevojës për themelimin e këtij komiteti, zhvillimin e aktiviteteve të përditshme të tij, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e komitetit për shërbime publike në funksion të përmirësimit të cilësisë gjatë ofrimit të shërbimeve publike nga ana e komunave.

Gjatë gjithë kohës, trajtim i veçantë në këtë doracak i jepet rolit të Kuvendit të Komunës, në përgjithësi dhe atij të anëtarit të Kuvendit të Komunës, në veçanti, në të gjitha pikat e diskutuara. Krahas kësaj, në këtë doracak jepen edhe udhëzime për organizimin e trajnimeve të posaçme në fushën e demokracisë lokale, në fushën e financave të pushtetit lokal, si dhe në atë të funksionimit të komitetit për shërbime publike të Kuvendit të Komunës.

Kapitulli I
Korniza ligjore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton parimet e përgjithshme të qeverisjes lokale (Neni 23). Sipas këtij neni, e drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme. Neni 24 rregullon organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale. Ky nen përcakton komunën si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale dhe parasheh që komunat të kenë të drejtë të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta, si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.

Ligji për vetëqeverisjen lokale (Nr. 03/L-040) ka për qëllim të vendosë bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës. Ky ligj përkufizon kompetencat e komunave dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, si organizimin dhe funksionimin e organeve komunale. Sipas këtij ligji, Kuvendi i Komunës mund të miratojë akte përbrenda fushës së kompetencave të tij (siç janë statuti i komunës, rregullorja e punës, rregulloret komunale, si dhe akte të tjera të nevojshme për funksionim efikas të komunës. Gjithashtu, sipas këtij ligji anëtarët e Kuvendit të Komunës kanë të drejtë të kërkojnë informacione rreth çështjeve komunale nga kryetari apo nga zëvendës kryesuesi i komitetit.

Ligjet e Republikës së Kosovës në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze mund të gjenden në ueb faqen e Kuvendit të Republikës së Kosovës http://www.kuvendikosoves.org

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë (Nr. 03/L-048), si dhe **Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji (Nr. 04/L-194)** rregullon përgatitjen, realizimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të Kosovës, buxheteve komunale dhe buxheteve të entiteteve të tjera publike që financohen nga paraja publike. Ky ligj gjithashtu përcakton përgjegjësitë e akterëve të përfshirë në këto procese në nivel qendror e lokal.

Ligji për qasje në dokumente publike (Nr. 03/L-215) i garanton secilit qytetar të drejtën për të pasur qasje në dokumentet e mbajtura, hartuara apo të pranuara nga institucionet publike. Ky ligj rregullon procedurat që duhet ndjekur për të siguruar qasje në dokumente publike dhe obligon institucionet publike, përfshirë komunat, që t'u kthejnë përgjegjje kërkesave për qasje në dokumente publike brenda shtatë ditësh.

Ligji për financat e pushtetit lokal (Nr. 03/L-049) rregullon mënyrën e financimit të komunave. Sipas këtij ligji, komunat kanë të drejtë të kenë burime të mjaftueshme financiare për të ushtruar kompetencat e tyre komunale. Komunat kanë të drejtë që, në mënyrë të pavarur, t'i rregullojnë dhe menaxhojnë burimet financiare nga të hyrat vetanake komunale dhe ato të cilat i janë ndarë komunës në formë të grantit të përgjithshëm.

Ky ligj më tej parasheh që, në rast të kompetencave të deleguara nga niveli qendror (siç janë shënimet kadastrale; regjistrimi civil, etj.) ose kompetencave të shtuara vetanake (siç është ofrimi i përkujdesit dytësor shëndetësor në disa komuna me shumicë serbe), Qeveria duhet të sigurojë fondet për ushtrimin e këtyre kompetencave nga ana e komunave. Ky ligj gjithashtu specifikon burimet e të hyrave vetanake (siç është, p. sh., tatimi në pronë) dhe të hyrave të tjera të komunave (siç është, p. sh., granti qeveritar për shëndetësi).

Rregulloret vjetore komunale mbi taksat, tarifat dhe ngarkesat janë dokumente vjetore me anë të të cilave përcaktohet vlera e tarifave, ngarkesave dhe gjobave për shërbimet komunale për personat fizikë dhe juridikë në territorin e komunës përkatëse. Kjo rregullore përfshin tarifat për lëshimin e vërtetimeve dhe dokumenteve zyrtare, për shërbime publike (p. sh., parking, regjistrim të automjeteve, etj.), për kompensim për shfrytëzimin e tokës (p. sh., të tokës publike para objekteve afariste, etj.), lejet e punës për ushtrimin e veprimtarive afariste, ngarkesat për ndërtimin dhe rrënimin e objekteve, gjobat për shkeljet e rregulloreve komunale, etj. Këto rregullore miratohen nga Kuvendi i Komunës pasi të shqyrtohen nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe pasi ky i fundit t'i japë kuvendit rekomandimet e tij.

Rregulloret vjetore mbi tatimin në pronë janë dokumente vjetore me anë të të cilave përcaktohen normat tatimore dhe kriteret e përcaktimit të bazës tatimore për tatimin komunal brenda komunës, si dhe standardet dhe procedurat që duhet të ndiqen nga komuna me rastin e administrimit të këtij tatimi.

Ligji për buxhetin përgatitet dhe miratohet në baza vjetore. Përgatitja e këtij ligji bëhet nga Ministria e Financave (MF) në koordinim me organizatat buxhetore (përfshirë komunat). Procesi i përgatitjes së buxhetit, si dhe roli dhe përgjegjësitë e komunave në këtë drejtim, trajtohen në pjesët përkatëse në vijim të këtij doracaku.

Rregulla financiare e Thesarit (Nr. 01/2010) është akt nënligjor i këtij ligji i cili përcakton parimet e menaxhimit financiar dhe kontrollit për organizatat buxhetore, përfshirë komunat. Ajo përkufizon zinxhirin e llogaridhënies, ku secili pjesëmarrës ka role dhe përgjegjësi të qarta, ka objektiva të qarta të performancës dhe kapacitetet për t'i përmbushur objektivat, duhet të raportojë për të arriturat (të matura në raport me objektivat e përcaktuara paraprakisht), si dhe duhet të rishikojë performancën dhe të marrë masa për ta përmirësuar atë në rast nevoje.

Zinxhiri i llogaridhënies në komunë sipas kësaj rregulle është paraqitur në diagramin më poshtë (Figura 1). Kryetari/ja e komunës zgjidhet nga populli, prandaj i jep drejtpërdrejt llogari popullit. Kryetari/ja e komunës udhëheq qeverinë e komunës dhe administrimin/funksionet e saj, andaj atij/asaj i raportojnë zyrtari kryesor financiar, drejtori i buxhetit dhe auditori i brendshëm.

Kuvendi i Komunës mbikëqyr punën e kryetarit/es (qeverisë së komunës) dhe i jep llogari drejtpërdrejt popullit. Rolet e institucioneve të ndryshme në menaxhimin e financave komunale dhe linjat e raportimit diskutohen më hollësisht në pjesët në vazhdim.



Figura 1: Zinxhiri i llogaridhënies në komunë

Udhëzimi administrativ për transparencën në komuna (Nr. 2008/09) rregullon pjesëmarrjen e publikut në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij, mbledhjet me publikun, detyrimin për njoftim publik dhe konsultimin e publikut para miratimit të akteve komunale, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në dokumentet zyrtare të komunave. Sipas këtij udhëzimi, komunat obligohen që, krahas organizimit të së paku dy takimeve publike gjatë vitit, të organizojnë edhe takime shtesë për çështje që lidhen me buxhetin e komunës, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikimin hapësinor, investimet, të hyrat komunale, etj.

Kapitulli II

Demokracia lokale

1. Kuvendi i Komunës

Në sistemin e vetëqeverisjes lokale të Republikës së Kosovës komuna është njësia themelore e vetëqeverisjes me ç'rast i gjithë territori i Kosovës është i ndarë në 38 komuna. Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës janë organet kryesore të komunës dhe që të dyja zgjedhën veç e veç dhe me votat e drejtpërdrejta të qytetarëve të komunës.

Edhe kompetencat e Kuvendit të Komunës dhe të kryetarit të komunës janë të ndara. Kuvendi i Komunës vendos për politikat e përgjithshme në komunë, duke përfshirë miratimin e buxhetit, rregulloret e veçanta, etj. Kryetari është përgjegjës për zbatimin e politikave me ndihmën e drejtorëve sektorialë.

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë i komunës i përbërë nga anëtarët e tij të cilët zgjedhen drejtpërdrejt nga qytetarët dhe udhëhiqen nga kryesuesi i cili zgjedhet me shumicë votash nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

1.1 Komitetet e Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës ka nevojë për organe ndihmëse me qëllim të shqyrtimit të hollësishëm të politikave, dokumenteve strategjike, vendimeve dhe rregulloreve të komunës, nga njëra anë, si dhe me qëllim të mbikëqyrjes së veprimtarive të degës ekzekutive, në anën tjetër. Andaj, Kuvendi i Komunës themelon komitete të posaçme të cilat e ndihmojnë atë në përmbushjen e këtyre obligimeve dhe ushtrimin e këtyre kompetencave.



Figura 2: Kategoritë e komiteteve të Kuvendit të Komunës

1. Komitetet obligative – Kuvendi i Komunës është i obliguar që të themelojë dy komitete obligative: a) Komitetin për Politikë dhe Financa; dhe b) Komitetin për Komunitete.

a. Komiteti për Politikë dhe Financa konsiderohet si organi kryesor i Kuvendit të Komunës, i cili shqyrton paraprakisht pothuajse të gjitha çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës. Kështu, komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e:

1) të gjitha politikave,
2) dokumenteve fiskale dhe financiare,
3) planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik,
4) kornizës vjetore buxhetore afatmesme,
5) planit vjetor të prokurimit,
6) rregullores vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat,
7) planit vjetor të punës për auditimin e brendshëm,
8) planit buxhetor vjetor, afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe
9) marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin komunal.

Gjatë themelimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës duhet të ketë kujdes për përmbushjen e disa kritereve:

1) Maksimumi i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa është 11 dhe minimumi 5 anëtarë (varësisht nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit të Komunës).
2) Numri i anëtarëve të një subjekti politik në Komitetin për Politikë dhe Financa përcaktohet nga numri i anëtarëve të po atij subjekti politik në Kuvendin e Komunës.
3) Me kalimin e një anëtari të Komitetit për Politikë dhe Financa nga një subjekt politik në subjektin tjetër politik, ai/ajo e humb mandatin e subjektit politik i cili e ka deleguar në Komitetin për Politikë dhe Financa.
4) Në mungesë të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, i cili njëherësh është edhe Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa, mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa i udhëheq anëtari më i moshuar i këtij komiteti.
5) Gjatë themelimit të Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të sigurohet përfaqësimi gjinor prej 30%.

b. Komiteti për Komunitete – është komiteti i dytë obligativ i Kuvendit të Komunës detyrë e të cilit është:

1) Shqyrtimi i përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim.
2) Shqyrtimi i të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se respektohen plotësisht të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

3) I rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për të avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Gjatë themelimit të Komitetit për Komunitete duhet të sigurohet që:

1) Çdo komunitet që jeton në komunë të ketë të paktën një përfaqësues në Komitetin për Komunitete.
2) Shumica e anëtarëve të Komitetit për Komunitete njëherësh të jenë përfaqësues të komuniteteve të cilat jetojnë në komunë.
3) Shumica e anëtarëve të Komitetit për Komunitete njëherësh të jenë edhe anëtarë të Kuvendit të Komunës.

2. Komitetet e tjera – krahas komiteteve obligative, Kuvendi i Komunës mund të themelojë edhe komitete të tjera, numri dhe lloji i të cilave përcaktohet varësisht nga vullneti dhe nevojat e Kuvendit të Komunës. Këto komitete në shumë raste quhen edhe si komitete të përhershme, komitete profesionale apo komitete funksionale. Kuvendi i Komunës në parim, varësisht nga numri dhe emërtimi i drejtorive të Komunës, paralelisht themelon edhe komitete të tjera. Në këtë kuptim, Kuvendi i Komunës mund të themelojë:

a. Komitet për Shërbime Publike
b. Komitet për Arsim
c. Komitet për Shëndetësi
d. Komitet për Urbanizëm, etj.

Legjislacioni mbi vetëqeverisjen lokale, për dallim prej komiteteve obligative, nuk ka bërë përcaktimin e anëtarësisë së këtyre komiteteve. Andaj, në praktikë mund të hasen forma të ndryshme të përcaktimit të anëtarësisë. Bie fjala, derisa në një komunë anëtarë të këtyre komiteteve janë vetëm anëtarët e Kuvendit të Komunës, në komunën tjetër anëtarë të këtyre komiteteve janë edhe qytetarët ekspertë (kryesisht anëtarë të subjekteve politike) të fushave përkatëse. E dëshirueshme do të ishte që anëtarë të komiteteve përkatëse të jenë vetëm anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe atë për tre arsye:

1) Me emërimin e qytetarëve për anëtarë të këtyre komiteteve, barazohet fuqia politike e një anëtari të komitetit i cili njëherësh është edhe anëtar i Kuvendit të Komunës (dhe i cili është sprovuar në zgjedhje të drejtpërdrejta me votat e qytetarëve) me fuqinë e një anëtari i cili nuk posedon fuqi politike dhe nuk është anëtar i Kuvendit të Komunës. Një veprim i tillë ndikon drejtpërdrejt edhe në fuqinë politike të vetë komitetit, sidomos gjatë mbikëqyrjes së punës së ekzekutivit të komunës.
2) Në një situatë kur të gjitha komunat ballafaqohen me probleme financiare, Kuvendi i Komunës duhet të ketë kujdes me numrin e anëtarëve të këtyre komiteteve e ndoshta edhe me vetë numrin e komiteteve të cilat i themelon. Me emërimin e qytetarëve për anëtarë të këtyre komiteteve, krahas anëtarëve të cilët janë edhe anëtarë të Kuvendit të Komunës, rritet kostoja financiare e nevojshme për sigurimin e funksionalitetit të atij komiteti. Për shembull, nëse kostoja për një mbledhje e një komiteti i cili ka 5 anëtarë (të gjithë anëtarë të Kuvendit të Komunës) është 250 Euro, kostoja për një mbledhje e një komiteti i cili ka 7 anëtarë (të supozojmë se 2 prej tyre janë qytetarë) do të jetë 350 Euro.

3) Nëse Kuvendi i Komunës dëshiron të themelojë një komitet të caktuar dhe konsideron se në kuadër të anëtarëve të tij nuk ka persona të kualifikuar në profesionin përkatës dhe që, si të tillë, nuk mund t'i përmbushin objektivat dhe qëllimet e komitetit, atëherë Kuvendi i Komunës mund të themelojë komitete konsultative.

3. Komitetet Konsultative – Kuvendi i Komunës themelon komitete konsultative apo këshillëdhënëse sektoriale me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes në komunë. Kuvendi i Komunës mund të themelojë edhe komitete konsultative ad-hoc apo të përkohshme për çështje të caktuara, mandati i të cilave pushon pas përfundimit të çështjes. Kështu Kuvendi i Komunës mund të themelojë:

a. Komitet Konsultativ për Zhvillim Ekonomik

b. Komitet Konsultativ për Transparencë etj.

Gjatë themelimit të komiteteve konsultative, Kuvendi i Komunës duhet të kujdeset për plotësimin e disa kritereve:

1) Anëtarë të komiteteve konsultative mund të jetë vetëm qytetarët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile nga sektori përkatës.
2) Anëtarë të komitetit konsultativ mund të jetë vetëm qytetarët e komunës përkatëse dhe jo të komunave të tjera.
3) Anëtarët e komitetit konsultativ duhet të zgjedhen përmes procesit të hapur të konkursit dhe vetëm pas përmbushjes së kritereve profesionale.
4) Anëtarët e komitetit konsultativ zgjedhën nga paneli përzgjedhës i themeluar nga Kuvendi i Komunës, anëtarë të të cilit duhet të jenë përfaqësues nga Kuvendi i Komunës dhe shoqëria civile.
5) Gjatë themelimit të komiteteve konsultative duhet të sigurohet përfaqësimi gjinor prej 30%

Ndër detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve konsultative mund të përmenden:

1) Dhënia e propozimeve për rregullore;
2) Hulumtimet;
3) Dhënia e mendimeve, propozimeve për kryetarin, kuvendin, komitetet;
4) Paraqitja e pikëpamjeve të qytetarëve;
5) Dhënia e propozimeve për zgjidhje të problemeve, etj.

Krahas elementeve të paraqitura më sipër, duhet theksuar se komitetet konsultative duhet t'i kenë 5 deri në 9 anëtarë, duhet të mbajnë së paku katër mbledhje gjatë një viti dhe për secilën mbledhje duhet të mbahet procesverbal. Mbledhjet e komitetit konsultativ i thërret kryesuesi apo 1/3 e anëtarëve, ndërkohë që ato kryesohen nga kryesuesi ose anëtari më i vjetër nga mosha. Mandati i anëtarëve të komitetit konsultativ është 3 vjet, me ç'rast 1/3 e anëtarëve zgjedhën çdo vit. Një qytetar mund të jetë anëtar i komitetit konsultativ për më së shumti dy mandate të njëpasnjëshme.

Në lidhje me të gjitha kategoritë e komiteteve të Kuvendit të Komunës është me rëndësi të theksohen edhe disa elemente shtesë. **E para**, secili anëtar i Kuvendit të Komunës mund t'iu drejtohet të pranishmeve në cilindo komitet të Kuvendit të Komunës anëtar i të cilit nuk është, por nuk mund të votojë. Krahas kësaj, ai apo ajo mund t'i propozojë kryesuesit të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është përgjegjësi e komitetit. **E dyta**, sikurse nga të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës, edhe nga mbledhjet e të gjitha komiteteve të Kuvendit të Komunës mbahen procesverbale në pajtim me legjislacionin për përdorimin e gjuhëve. **E treta**, sikurse për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës, edhe për mbledhjet e të gjitha komiteteve të Kuvendit të Komunës qytetarët duhet të njoftohen 7 ditë pune para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë pune para mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe atë përmes shpalljes së njoftimeve publike në vendet më të frekuentuara, mediumeve të shkruara dhe elektronike, si dhe përmes faqes zyrtare të komunës në internet.

1.2 Grupet e anëtarëve në Kuvendin e Komunës

Për të ndikuar në rritjen e efikasitetit të Kuvendit të Komunës, krahas themelimit të komiteteve, me rëndësi është edhe themelimi dhe funksionimi i grupeve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Për fat të keq, legjislacioni mbi vetëqeverisjen lokale nuk ofron asnjë instrument për themelimin dhe funksionimin e grupeve të kuvendeve të komunave, duke bërë kështu që të shpërfaqen modele të ndryshme nëpër komuna të procedurave të themelimit, anëtarësisë, veprimit dhe vendimmarrjes së grupeve të kuvendeve të komunave. Megjithatë, në esencë ekzistojnë dy lloje të grupeve të anëtarëve të kuvendeve të komunave: 1. Grupet e subjekteve politike (grupet parlamentare); dhe 2. Grupet e grave (anëtare të kuvendeve të komunave).

1. Grupet e subjekteve politike (grupet parlamentare) – paraqesin grupin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës të cilët kanë synime dhe qëllime të përbashkëta apo të përafërta dhe të cilët kanë një agjendë të përbashkët e të cilën synojnë ta realizojnë bashkërisht. Këto grupe mund të grumbullojnë rreth vetes anëtarë të një subjekti politik, por ka shumë raste kur pjesë e një grupi parlamentar bëhen dy ose më shumë subjekte politike.Varësisht nga synimet dhe qëllimet e përcaktuara, si dhe nga numri i anëtarëve dhe subjekteve politike që janë pjesë e tyre, grupet parlamentare mund të shfaqen si një koalicion mjaft i ngjeshur dhe me ndikim të madh në vendimmarrje. Nga ana tjetër, shumësia e subjekteve politike të cilët janë pjesë e një grupi parlamentar mund të bëjë që ajo të mos shfaqet si një koalicion i fortë dhe në shumicën e rasteve ato përfundojnë si koalicione afatshkurta të bazuara në çështje specifike.



Ekzistojnë disa parakushte që do të duhej të përmbusheshin për të arritur deri te funksionimi normal i një grupi parlamentar:

- **Struktura (hierarkia) e grupit** – secili grup parlamentar duhet ta ketë udhëheqësin e tij i cili e përfaqëson grupin. Kjo ndikon drejtpërdrejt në krijimin e një zinxhiri vendimmarrës brenda grupit dhe lehtëson prezantimin e qëndrimeve të grupit parlamentar.
- **Rregullorja e punës** – sikurse për çdo strukturë tjetër të organizuar, grupet parlamentare duhet të punojnë duke u bazuar në një rregullore të brendshme përmes së cilës përcaktohen të gjitha elementet e duhura të cilat janë të nevojshme për funksionimin e grupit parlamentar.
- **Mbledhjet e rregullta** – grupet parlamentare duhet të mbajnë mbledhje të rregullta, në të cilat paraprakisht përcaktohen qëndrimet e grupit karshi pikave të rendit të ditës të parapara për t'u diskutuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës. Kjo ndihmon në shmangien e diskutimeve të gjata dhe politizimin e çështjeve në kuvend.
- **Procesverbali** – mbledhjet e grupeve parlamentare duhet të evidentohen me anë të procesverbalit. Në këtë mënyrë garantohet konsistenca në qëndrimet e grupit dhe transparenca në punën e tij.

Grupet parlamentare duhet të diskutojnë çështjet apo pikat e rendit të ditës së mbledhjes së Kuvendit të Komunës para se ato çështje dhe pika të diskutohen në Kuvend, pra para mbledhjes së Kuvendit të Komunës. Grupi duhet të mundohet të arrijë konsensus të brendshëm lidhur me secilën çështje e cila do të diskutohet në kuvend. Megjithatë, grupet parlamentare në asnjë rrethanë nuk duhet të shërbejnë si mekanizëm i cili e cungon mendimin e lirë të anëtarit të grupit. Padyshim që secili anëtar i Kuvendit të Komunës, pa marrë parasysh nëse i takon grupit parlamentar apo jo, e ka të drejtën e garantuar të prezantimit të qëndrimeve të tij/saj në mbledhjen e Kuvendit të Komunës dhe atë për secilën pikë të rendit të ditës. Madje, anëtari i kuvendit ka të drejtë që të kërkojë edhe shtimin e pikave të rendit të ditës në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës.

Faktor me rëndësi që ndikon në suksesin e grupit parlamentar janë format e komunikimit të cilat i shfrytëzon grupi. Debatet në Kuvendin e Komunës janë formë klasike e paraqitjes së qëndrimeve të grupit parlamentar rreth një çështjeje të caktuar. Po aq i rëndësishëm është edhe prezantimi i qëndrimeve të grupit parlamentar përmes mediumeve të shkruara apo elektronike, si dhe, normalisht, shfrytëzimi i rrjeteve sociale si forma bashkëkohore të komunikimit me publikun. Grupi parlamentar duhet të ketë komunikim të rregullt me votuesit përmes formave të ndryshme të komunikimit, me qëllim të bartjes së mesazhit të grupit parlamentar te qytetarët. Kjo formë e komunikimit të grupit parlamentar i shërben edhe si platformë për promovimin e politikave të subjektit politik përballë votuesve.

2. Grupet e grave – duke pasur parasysh faktin se së paku 30% e anëtarëve të Kuvendit të Komunës janë gra, lehtë mund të kuptohet rëndësia që kanë gratë në procesin e vendimmarrjes në Kuvendin e Komunës. Në shumicën e rasteve, gratë anëtare të kuvendeve të komunave themelojnë grupe të posaçme të grave në këto institucione. Synim parësor i themelimit të grupeve të grave gjithmonë mbetet avancimi dhe fuqizimi i gruas në komunë, në përgjithësi, dhe në Kuvendin e Komunës, në veçanti. Synime të tjera të grupeve të grave janë rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, mbrojtja dhe promovimi i interesave të grave, si dhe emancipimi i mëtejmë i grave. Grupet e grave në esencë janë grupe të anëtarëve të kuvendeve të komunave pjesë e së cilës janë vetëm gratë. Në disa raste, pjesë e grupeve të grave janë edhe gratë të cilat nuk janë anëtare të Kuvendit të Komunës, sikurse Zyrtarja për Barazi Gjinore, gratë përfaqësuese të shoqërisë civile, forumet e grave të subjekteve politike, etj.

Ngjashëm me grupet parlamentare, edhe për grupet e grave vlejnë parakushte që duhet të përmbushen për të mundësuar funksionimin normal të një grupi të grave:

- **Struktura (hierarkia) e grupit** – grupi i grave duhet të ketë një udhëheqëse që e përfaqëson grupin. Kjo ndikon drejtpërdrejt në krijimin e një zinxhiri vendimmarrës brenda grupit dhe lehtëson prezantimin e qëndrimeve të grupit të grave.
- **Rregullorja e punës** – grupet e grave duhet të punojnë bazuar në rregullore të brendshme, përmes së cilës përcaktohen të gjitha elementet e duhura të nevojshme për funksionimin e grupit të grave.
- **Mbledhjet e rregullta** – grupet e grave duhet të mbajnë mbledhje të rregullta, në të cilat paraprakisht përcaktohen qëndrimet e grupit karshi pikave të rendit të ditës të parapara për t'u diskutuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës. Këtij parimi duhet t'i përmbahen posaçërisht në rastet kur në rend dite janë çështje të cilat drejtpërdrejt i prekin gratë e komunës, sikurse janë buxheti komunal, rregullorja për tatimin në pronë, rregullorja për taksa, dokumentet e ndryshme strategjike, etj.
- **Procesverbali** – mbledhjet e grupeve të grave duhet të evidentohen me anë të procesverbalit. Në këtë mënyrë garantohet konsistenca në qëndrimet e grupit dhe transparenca në punën e tij.

Roli i anëtarit të Kuvendit të Komunës

Niveli i angazhimit individual i anëtarëve të kuvendit ka ndikim të madh në efikasitetin e përgjithshëm të tij. Ndër elementet të cilat përcaktojnë "aktivizimin" e një anëtari të Kuvendit të Komunës mund të përmenden:

1) angazhimi për përfaqësimin e interesave të qytetarëve,
2) paraqitja e brengave, kërkesave dhe shqetësimeve të qytetarëve,
3) parashtrimi i pyetjeve për ekzekutivin,
4) mbikëqyrja e realizimit të investimeve kapitale,
5) mbikëqyrja e realizimit të buxhetit, etj.

Për ta arritur nivelin e angazhimit të cilin qytetarët e presin nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, secili anëtar i saj duhet t'u përmbahet parimeve bazë të sjelljes dhe angazhimit:

6) Të kontribuojë përmes dhënies së informatave,
7) Të kërkojë informata shtesë nga ekzekutivi,
8) Të ketë sjellje konstruktive,
9) Të marrë shënime,
10) Të mos përsëritë argumentet,
11) Të marrë pjesë në diskutim vetëm kur t'i jepet fjala,
12) T'i përmbahet rendit të ditës,
13) Të shmangë ofendimet dhe fyerjet,
14) Të ruajë disiplinën.

Fusha a angazhimit të mundshëm e grupit të grave është mjaft e gjerë. Këto grupe fillimisht angazhohen për hulumtimin dhe konstatimin e pozitës së grave, pastaj ofrojnë rekomandime për trajtimin e problemeve me të cilat ballafaqohen gratë, i shqyrtojnë propozimet dhe iniciojnë planet lokale për barazi gjinore, si dhe propozojnë masat e nevojshme për realizimin e programeve shëndetësore, kulturore, arsimore dhe çështjet gjinore. Grupet e grave bashkëpunojnë dhe i bashkërendojnë aktivitetet me Grupin e Grave të Kuvendit të Kosovës dhe të komunave të tjera, me Agjencinë për Barazi Gjinore dhe me të gjithë mekanizmat e tjerë që cilët promovojnë barazinë gjinore.

Grupi i grave mund të organizojë takime publike me grupe të grave, OJQ të grave, institucione dhe grupe të tjera të interesit, të organizojë fushata edukimi dhe avokimi, të bëjë hulumtime, analiza dhe anketa, si dhe aktivitete të tjera të ngjashme.

Format e komunikimit të cilat i shfrytëzon grupi i grave kanë ndikim të madh në punën dhe rezultatet e tij. Njëra prej formave të komunikimit të qëndrimeve të grupit të grave janë debatet në Kuvendin e Komunës; në këtë kontekst, është e domosdoshme që të rritet angazhimi dhe pjesëmarrja në diskutime e grave anëtare të Kuvendit të Komunës. Prezantimi në mediume të shkruara dhe elektronike i qëndrimeve të grupit të grave dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me votuesit ndikon shumë në përcjelljen e mesazhit te të gjithë qytetarët.

1.3 Kuvendi i Komunës dhe këshillat e fshatrave

Struktura e ashtuquajtur nën komunale e organizimit të qeverisjes ka qenë dhe vazhdon të jetë ndër format më të sigurta të afrimit të qytetarëve me proceset e vendimmarrjes në komunë. Krahas kësaj, kjo strukturë mund t'i kryejë me efikasitet disa punë të cilat janë kompetencë e komunave dhe për zbatimin e të cilave komunat mund të kenë vështirësi. Korniza ligjore e vetëqeverisjes lokale e Kosovës, megjithëse nuk trajton shumë elemente të saj, ofron kornizën bazë mbi të cilën mund të formësohet bashkëpunimi në mes të komunës dhe nivele nën komunale të organizimit.

Niveli nën komunal i organizimit të qeverisjes në Kosovë haset me emërtime të ndryshme: diku njihet si bashkësi lokale, diku si këshill lokal e diku tjetër si këshill i fshatit. Sidoqoftë, me rëndësi është se edhe komunat në Kosovë kanë të drejtë të bashkëpunojnë me këta këshilla. Një veprim i tillë duhet të përcillet me miratim zyrtar të Kuvendit të Komunës, ndërsa këtij hapi duhet t'i paraprijë një proces mjaft i ndërlikuar i zgjedhjes së këshillave të fshatrave apo të bashkësive lokale.

Bashkëpunimi i komunës me këshillat e fshatrave apo bashkësive lokale realizohet përmes një marrëveshjeje të cilën komuna e lidh me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane. Një marrëveshje e tillë duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës si organi më i lartë vendimmarrës në komunë.
Komunat kanë të drejtë të lidhin marrëveshje me fshatrat, lagjet apo vendbanimet brenda territorit të tyre për t'u ofruar shërbime qytetarëve nga afër. Me miratimin e komunës, fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, vetë apo në mënyrë të kombinuar, mund të kryejnë aktivitete që hyjnë në kuadër të përgjegjësive dhe kompetencave të komunës. Në këtë rast, komunat ofrojnë burime të mjaftueshme për fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Subjekt i marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të komunës dhe këshillave të fshatrave apo bashkësive lokale mund të jenë kompetencat vetanake të komunave, duke përfshirë ndër të tjera edhe:

- Planifikimin urban dhe rural;
- Furnizimin me ujë, rregullimin e kanalizimit;
- Shëndetësinë publike;
- Mbrojtjen lokale të mjedisit;
- Turizmin;
- Hapësirat e hapura dhe varrezat;
- Aktivitetet kulturore dhe sportive, etj.

Krahas kësaj, roli i këshillave të fshatrave apo i bashkësive lokale lidhet kryesisht me shqyrtimin e çështjeve në interes të lokalitetit; hartimin dhe miratimin e planit të punës së këshillit dhe rregullave të brendshme të funksionimit; organizimin, përcjelljen dhe planifikimin e planeve dhe programeve zhvillimore të lokalitetit; organizimin e takimeve të qytetarëve me zyrtarët komunalë; dhe çështje të tjera të ngjashme. Megjithatë, një nga sfidat më të mëdha të funksionalizimit të këshillave të fshatrave apo të bashkësive lokale në Kosovë mbetet financimi i këtyre mekanizmave. Meqenëse në aspektin ligjor këto organe nuk njihen si kategori ligjore e qeverisjes nën komunale, problematikë e pakapërcyeshme mbetet financimi i funksionimit të këtyre trupave. Andaj, komunat janë të detyruara të gjejnë forma dhe mënyra të ndryshme me qëllimin e vetëm që këshillat e fshatrave apo bashkësitë lokale të funksionojnë. Financimi i këtyre mekanizmave mund të bëhet përmes vetëfinancimit të banorëve, financimit të donatorëve, financimit të përbashkët apo financimit nga ana e komunës. Por, financimi nga ana e komunës nuk mund të bëhet në formën e pagesës së pagës apo të mëditjes për kryetarët apo anëtarët e këshillave të fshatrave apo të bashkësive lokale.

Roli i anëtarit të Kuvendit të Komunës

Funksionimi i këshillave të fshatrave apo bashkësive lokale u jep mundësi të shumta anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Para së gjithash, këto organe për anëtarët e Kuvendit të Komunës ofrojnë:

1) Mundësi për komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarët;
2) Sigurim të informatës mbi kërkesat, problemet dhe rekomandimet e qytetarëve;
3) Mobilizim i qytetarëve për çështje avokuese;
4) Përfshirje e qytetarëve në proces të buxhetimit;
5) Mundësi për shtrirje të ndikimit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës;
6) Mundësi për rritje të mbikëqyrjes së punës së ekzekutivit;
7) Mundësi për rritje të mbikëqyrjes së zbatimit të investimeve kapitale; etj.

1.4 Komunikimi me publikun

Një nga shtyllat kryesore të sistemit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë është transparenca komunale. Ajo paraqitet si obligim të cilit duhet t'i përmbahen autoritet lokale pothuajse në çdo veprim të tyre. Komunikimi i drejtpërdrejtë i autoriteteve lokale me publikun në këtë kontekst mbetet mjet i pazëvendësueshëm i transparencës lokale.

Komunikimin me publikun të autoriteteve lokale mund ta kategorizojmë në tri nivele:

1. Takimet publike – janë takime të cilat komunat janë të obliguara t'i mbajnë së paku dy herë në vit. Në këto takime qytetarët informohen nga udhëheqësit e komunës për aktivitetet e komunës, si dhe mund të parashtrojnë pyetje dhe të japin propozime në lidhje me kompetencat komunale për udhëheqësit e komunës.

2. Konsultimet publike – janë takime të cilat komunat duhet t'i organizojnë para se Kuvendi i Komunës të marrë vendim mbi çështje të interesit të përgjithshëm sikurse janë rregulloret e Kuvendit të Komunës, planet zhvillimore dhe dokumentet e tjera strategjike. Konsultimet publike duhet të organizohen nga ana e propozuesit të aktit. Organi propozues i aktit merr pjesë aktivisht në konsultim, shpjegon përmbajtjen e aktit para publikut dhe evidenton propozimet e dhëna nga publiku gjatë konsultimeve. Krahas kësaj, organi propozues i aktit duhet të informojë Kuvendin e Komunës për propozimet e dhëna në diskutim publik duke përfshirë propozimet e refuzuara dhe ato të marra parasysh. Kuvendi i Komunës më tej, në bazë edhe të propozimeve të paraqitura nga publiku gjatë diskutimit publik, merr vendim final në lidhje me përmbajtjen e aktit.

3. Dëgjimet publike – janë takime të cilat komunat duhet t'i organizojnë me qëllim të marrjes së kërkesave të qytetarëve në lidhje me dokumentet buxhetore të komunës. Takime të tilla komunat duhet të organizojnë për buxhetin komunal dhe për kornizën afatmesme të shpenzimeve.

Me qëllim të garantimit të cilësisë së dëshiruar gjatë organizimit të këtyre aktiviteteve publike, udhëheqësit e komunës duhet të sigurohen që vendi dhe koha e organizimit të këtyre aktiviteteve të jenë, para së gjithash, të përshtatshme për vetë publikun. Kështu, objektet shkollore, shtëpitë e kulturës, objektet sportive apo objektet e ngjashme të karakterit publik janë vendet më të përshtatshme për organizimin e takimeve, konsultimeve apo dëgjimeve publike. Objektet e komunës duhet të mbeten opsionet e fundit për organizimin e aktiviteteve të tilla me publikun. Nuk duhet harruar faktin se zyrtarët e komunës e kanë për obligim dhe detyrë që të "shkojnë" tek qytetarët dhe jo anasjelltas.

1.5 Demokracia e drejtpërdrejtë

Koncepti i demokracisë së drejtpërdrejtë në Kosovë shumë pak zbatohet. Rastet kur qytetarët vendosin vetë mbi çështjet që prekin interesat e tyre përmes angazhimit të drejtpërdrejtë në vendimmarrje janë pothuajse in-ekzistente. Në vendin tonë më tepër kemi të bëjmë me zbatimin e konceptit të demokracisë përfaqësuese, me ç'rast qytetarët ua delegojnë përfaqësuesve të zgjedhur nga ata të drejtën për të vendosur në emër të tyre.

Zbatimi i demokracisë së drejtpërdrejtë ka ndikime të shumta pozitive për shoqërinë, sepse në radhë të parë siguron pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes. Kjo formë e demokracisë po ashtu mundëson informim të drejtpërdrejtë të qytetarëve me aktivitetet dhe vendimet

e autoriteteve publike, pasi që qytetarët janë vetë të përfshirë në ato procese. Dhe së fundi, përmes zbatimit të demokracisë së drejtpërdrejtë, lehtësohet në masë të madhe zbatimi i vendimeve dhe minimizohet hapësira për shprehje të mospajtimeve apo pakënaqësive nga ana e qytetarëve.

Zbatimi i konceptit të demokracisë së drejtpërdrejtë me vete mbart edhe mjaft rreziqe. Fillimisht bëhet fjalë për vështirësinë e adresimit dhe rregullimit të aspektit ligjor të zbatimit të demokracisë së drejtpërdrejtë. Po ashtu, në një proces të vendimmarrjes ku zbatohet koncepti i demokracisë së drejtpërdrejtë rritet kostoja financiare e vetë procesit të vendimmarrjes. Si rezultat i të gjitha këtyre, mund të vije deri te vonesat në procesin e marrjes së vendimeve.

Megjithëse koncepti i demokracisë së drejtpërdrejtë shumë pak zbatohet në Kosovë, legjislacioni vendor i ka paraparë disa mekanizma zbatimi i të cilave do të mundësonte jetësimin e formës së avancuar të demokracisë edhe në Kosovë.

Në nivelin qendror të qeverisjes janë paraparë dy mekanizma: referendumi dhe iniciativa legjislative. Referendumin në nivel vendi e shpall Kuvendi i Kosovës dhe përgjegjës për organizimin e tij është autoriteti që bën organizimin e zgjedhjeve, që në këtë rast është Komisioni Qendror Zgjedhor. Mirëpo, legjislacioni thelbësor i Republikës së Kosovës nuk mund t'i nënshtrohet referendumit. Nga ana tjetër, dhjetë mijë qytetarë të Republikës së Kosovës mund të ndërmarrin iniciativë legjislative përmes së cilës i kërkojnë Kuvendit të Kosovës miratimin e një ligji.

Edhe në nivelin lokal të qeverisjes janë paraparë disa mekanizma të demokracisë së drejtpërdrejtë.

Referendumi - Qytetarët e komunës mund të kërkojnë që rregullorja e miratuar nga Kuvendi i Komunës t'i nënshtrohet referendumit. Kërkesa duhet t'i dorëzohet Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, brenda 30 ditësh nga data e miratimit të rregullores dhe ajo duhet të nënshkruhet nga 10% e votuesve të regjistruar në atë komunë.

Peticioni - Çdo person apo organizatë me interes në komunë ka të drejtën e prezantimit të peticionit në Kuvendin e Komunës për çfarëdo çështje që ndërlidhet me përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Kuvendi i Komunës e shqyrton peticionin në pajtim me Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës. Kuvendi i Komunës duhet ta shqyrtojë kërkesën brenda 30 ditësh pas pranimit të peticionit.

Iniciativa qytetare - Qytetarët mund të ndërmarrin iniciativë për të propozuar rregullore në kuadër të kompetencave të komunës për miratim nga Kuvendi i Komunës apo me votën e qytetarëve. Propozuesit ia dorëzojnë draftin e rregullores së propozuar Kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Projekt-rregullorja e propozuar duhet të nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar për t'u shqyrtuar nga Kuvendi i Komunës. Kuvendi i Komunës është i obliguar ta shqyrtojë rregulloren e propozuar brenda 60 ditësh pas pranimit.

Shkarkimi i Kryetarit të Komunës – Qytetarët e komunës mund të ndërmarrin iniciativë për largimin e Kryetarit të Komunës. Kërkesa e tillë duhet të nënshkruhet nga 20% e votuesve të regjistruar dhe i dorëzohet Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, i cili pastaj e paraqet çështjen në institucionin përkatës për administrimin e votimit. Nëse shumica e votuesve të regjistruar votojnë për largimin e kryetarit, zgjedhjet e reja për kryetar duhet të bëhen në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet.

Pyetje	Përgjegje
• Komiteti për Politikë dhe Financa: Si të përmirësohet performanca e komunës në grumbullimin e tatimit në pronë?	Të hyrat nga tatimi në pronë janë shumë të rëndësishme për komunën. Hollësitë e përcaktimit të tatimit në pronë, faturimit dhe vjeljes janë të përcaktuara me ligj. Kuvendi i Komunës është përgjegjës për miratimin e Rregullores për tatimin në pronë. Departamenti komunal i tatimit në pronë është kompetent për të gjitha procedurat e tjera. Kuvendi i Komunës mund të ketë rol aktiv në këtë proces. Nga anëtarët e grupit pritet që t'i identifikojnë format dhe modalitetet e rritjes së performancës së komunës në grumbullimin e tatimit në pronë, duke filluar nga vlerësimi i pronave, (ri)regjistrimi i pronave, grumbullimi i tatimit në pronë, kushtëzimet, etj.
• Komiteti për shërbime publike: Si të mbikëqyren shërbimet publike në komunën tuaj?	Komuna është përgjegjëse për ofrimin e një numri të madh të shërbimeve publike, duke përfshirë menaxhimin e mbeturinave, ndërtimin e rrugëve, trotuareve, kanalizimeve, mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, shesheve, inspektimin, etj. Komiteti për Shërbime Publike, pos tjerash, është kompetent për mbikëqyrjen e ofrimit të këtyre shërbimeve publike nga ana e komunës. Anëtarët e grupit duhet të analizojnë dhe t'i identifikojnë fushat e mundshme të mbikëqyrjes, format dhe modalitetet e mbikëqyrjes, si dhe t'i identifikojnë kapacitetet dhe nevojat e komitetit për ushtrimin e mbikëqyrjes.
• Grupi i grave: Si të fuqizohen bizneset e grave në komunën tuaj?	Komunat kanë kompetenca të kufizuara sa i përket zhvillimit të veprimtarisë së bizneseve private. Këtu përfshihen edhe ato biznese që udhëhiqen nga gratë. Sidoqoftë, rregulloret komunale për taksa, tarifa dhe gjoba komunale në shumë raste tërthorazi mund të jenë barrë apo lehtësim për këto biznese. Anëtarët e grupit duhet të identifikojnë cilat pjesë të Rregullores komunale për taksa, tarifa dhe gjoba komunale janë të papërshtatshme për bizneset e udhëhequra nga gratë, si dhe të ofrojnë alternativa për rregullimin e fushave specifike në mënyrë që të ndikohet në fuqizimin e bizneseve të grave.

• Komiteti për Politikë dhe Financa: Cilat janë problemet dhe mekanizmat e rritjes së kontrollit ndaj ekzekutivit?	Kompetencë e rëndësishme e Kuvendit të Komunës është ushtrimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes ndaj ekzekutivit të komunës, përkatësisht ndaj kryetarit të komunës dhe drejtorëve komunalë. Korniza ligjore për vetëqeverisjen lokale ka paraparë një sërë mekanizmash të kontrollit. Mirëpo mbetet problematike mos përcaktimi i masave ndëshkuese në raste të moszbatimit të këtyre mekanizmave (obligimeve për raportim). Anëtarët e grupit duhet t'i identifikojnë format dhe modalitetet e ushtrimit të kontrollit të Kuvendit të Komunës karshi ekzekutivit, përfshirë edhe gjetjen e alternativave për ushtrim të kontrollit në raste të moszbatimit të mekanizmave të kontrollit nga ana e ekzekutivit të komunës.
• Grupi i grave: Si të rritet pjesëmarrja e grave në proceset e vendimmarrjes në komunën tuaj?	Pjesëmarrja e grave në proceset vendimmarrëse në komuna është shumë e ulët. Kjo gjendje është edhe më e rënduar në ekzekutivin e komunave, ku në pozita udhëheqëse janë vetëm një numër simbolik i grave. Megjithatë, në praktikë ka mjaft mundësi për ta ndryshuar këtë gjendje në funksion të arritjes së barazisë shoqërore edhe në aspektin gjinor. Anëtarët e grupit duhet t'i identifikojnë format dhe modalitetet e mundshme të cilat do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte në rritjen e pjesëmarrjes së grave në pozitat vendimmarrëse në komuna.
• Cilat janë problemet të cilat i kanë anëtarët e kuvendit gjatë komunikimit me qytetarë dhe cilët janë mekanizmat për përmirësimin e tyre?	Anëtarët e kuvendeve të komunave në angazhimin e tyre sfidohen nga shumë mangësi, duke filluar nga statusi i tyre i pafavorshëm politik, kompensimi i ulët financiar, mungesa e kushteve dhe hapësirave të nevojshme për punë, si dhe shumë probleme tjera. Të gjitha këto bëjnë që pjesa më e madhe e anëtarëve të kuvendeve të komunave të kenë vështirësi në vendosjen e komunikimit të drejtpërdrejtë dhe të rregullt me qytetarët. Anëtarët e grupit duhet t'i identifikojnë format dhe mekanizmat të cilat sigurojnë vendosjen e komunikimit të rregullt të anëtarëve të kuvendeve të komunave me qytetarët, përkatësisht votuesit e komunës.

Kapitulli III

Financat komunale

1. Rolet e institucioneve në menaxhimin e financave komunale

Rolet e institucioneve në menaxhimin e financave komunale janë të rregulluara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Ligjin për vetëqeverisje lokale. Pjesët në vazhdim prezantojnë rolet e institucioneve komunale (pjesa 3.1) dhe atyre qendrore (pjesa 3.2).

1.1 Institucionet komunale

Komiteti për Politikë dhe Financa, posaçërisht, dhe Kuvendi i Komunës në përgjithësi, kanë përgjegjësi të madhe në fazat e planifikimit dhe mbikëqyrjes së financave komunale. Në fazën e planifikimit, Komiteti për Politikë dhe Financa shqyrton dokumente të rëndësishme si buxheti komunal, korniza afatmesme buxhetore komunale, plani i prokurimit, etj., si dhe i jep rekomandimet për veprime Kuvendit të Komunës. Ngjashëm, në fazën e mbikëqyrjes së financave komunale ky komitet shqyrton raportet e Kryetarit të Komunës dhe ndryshimet e propozuara të buxhetit dhe i jep rekomandime Kuvendit të Komunës.
Kuvendi i Komunës, bazuar në rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, shqyrton dhe, në rast pajtimi, miraton dokumentet kyçe të komunës që lidhen me menaxhimin e financave komunale, si:

- planin vjetor të punës;
- rregulloren vjetore komunale mbi taksat, tarifat dhe ngarkesat;
- kornizën afatmesme buxhetore të komunës;
- buxhetin komunalë dhe ndryshimet e buxhetit;
- planin investues të komunës;
- planin e prokurimit;
- raportet financiare të pranuara nga Kryetari i Komunës; etj.

Rolet e institucioneve komunale në proceset e përpilimit dhe implementimit të buxhetit, si dhe të mbikëqyrjes së financave komunale janë paraqitur në diagramet më poshtë (Figurat 3, 4 dhe 5, respektivisht).



Figura 3: Rolet e institucioneve komunale në përpilimin e buxhetit komunal



Figura 4: Rolet e institucioneve komunale në implementimin e buxhetit komunal



Figura 5: Rolet e institucioneve komunale në mbikëqyrjen e financave komunale

1.2 Institucionet qendrore

Departamenti i Buxhetit Komunal është departament në kuadër të Ministrisë së Financave që merret me financat komunale. Ky departament është i përfshirë në proceset e:

- Planifikimit të financave komunale:
  - Përgatit propozim-buxhetin për komuna;
  - Përgatit pjesën e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) Komunale.
- Zbatimit të financave komunale:
  - Ndihmon komunat në zbatimin e buxhetit;
  - Shqyrton dhe vlerëson kërkesat për ndryshimin e ndarjeve buxhetore;
  - Analizon dhe ofron rekomandime rreth transfereve, rialokimeve dhe dorëzimeve të tjera që kanë të bëjnë me ndarjet buxhetore;
  - Menaxhon sistemin elektronik të të dhënave (BDMS), Programin e Investimeve Publike (PIP) apo sistemet e tjera që përdoren nga komunat; etj.

Analistët e Buxhetit Komunal në kuadër të këtij Departamenti bashkëpunojnë me zyrtarë komunalë për të gjitha çështjet e menaxhimit financiar të komunave. Për shembull, ata pranojnë kërkesat nga komunat dhe i dorëzojnë për procedim; informojnë dhe këshillojnë komunat me qëllim të respektimit të kornizës ligjore dhe vendimeve të marra në nivel ministror; informojnë dhe këshillojnë komunat në rast se ka deficit të mjeteve në kategoritë ekonomike; etj.

Komisioni i Granteve është institucion ndërqeveritar i përcaktuar me Ligjin për financat e pushtetit lokal. Ky Komision përbëhet nga shtatë anëtarë: Kryeministri, Ministri i Financave, një ministër tjetër (i përzgjedhur në baza vjetore) dhe katër kryetarë komunash (të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme në baza vjetore, por me kusht që njëri të vijë nga komunat e pakicave kombëtare). Përgjegjësitë kryesore të këtij komisioni janë:

- Të shqyrtojë formulën për ndarjen e granteve çdo tre vite;
- Në baza vjetore, të përcaktojë formulën e granteve me sistem të hapur (të shëndetësisë dhe të arsimit);
- Të shqyrtojë ankesat e komunave rreth formulave të financimit dhe propozimet e tyre për shpenzime kapitale;
- Të rekomandojë shumën e financimit shtesë për komunat të cilave u janë dhënë kompetenca të shtuara; etj.

2. Burimet e financimit të komunave

2.1 Të hyrat vetanake të komunave

Burimet e të hyrave vetanake të komunave janë të përcaktuara me Ligjin për financat e pushtetit lokal, siç vijon[1]:

- Taksa në pronën e paluajtshme (aktualisht aplikohet për objekte, por nga viti 2017 do të zgjerohet gradualisht duke përshirë edhe tokat);
- Taksa për lejen e ushtrimit të veprimtarisë afariste;
- Taksat për lejen për shërbime profesionale;
- Taksa për automjetet motorike;
- Taksat administrative komunale;
- Taksat për lejet për ndërtimin dhe rrënimin e ndërtesave dhe strukturave të tjera;
- Taksat për lëshimin e çertifikatave dhe dokumenteve zyrtare;
- Tarifat rregullative për zhvillimin ose ruajtjen e infrastrukturës;
- Gjobat në trafik;
- Gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale;
- Të hyrat nga qiradhënia;
- Bashkë-pagesat për arsim dhe shëndetësi.

Shumica e kategorive të të hyrave më lart janë të hyra direkte, do të thotë se administrohen dhe mblidhen nga vetë administrata komunale. Nga ana tjetër, disa prej tyre (siç janë gjobat e trafikut) janë të hyra indirekte, do të thotë se mblidhen nga ministritë apo agjencitë përkatëse në nivel qendror dhe më pas transferohen në llogarinë e komunës përkatëse. Pavarësisht nga forma e mbledhjes, të gjitha të hyrat vetanake të komunës duhet të depozitohen në nën-llogarinë për të hyrat vetanake të komunës përkatëse në Buxhetin e Kosovës, brenda llogarisë së Thesarit.

Vendosja e taksave, tarifave dhe gjobave, dhe vlera e tyre rregullohet në baza vjetore nga secila komunë me rregulloren për taksat, tarifat dhe ngarkesat, e cila duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës. Megjithatë, vlera dhe mënyra e shfrytëzimit të disa prej taksave, tarifave e gjobave duhet të jenë në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në ligje të fushave përkatëse. Kështu, në përputhje me Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme (Nr. 03/L-204), baza tatimore për tatimin në pronë bazohet në vlerën e tregut, ndërsa tarifa tatimore që mund ta zbatojë komuna mund të jetë në shkallën prej 0.05% deri 1% të kësaj vlere. Ngjashëm, lartësia e gjobave në trafik përcaktohet me Ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor (Nr. 02/L-70), megjithëse ato konsiderohen si të hyra vetanake të komunës ku shqiptohet dënimi.

Në përputhje me Ligjin për financat e pushtetit lokal, taksat për lëshimin e çertifikatave dhe dokumenteve zyrtare dhe taksat administrative nuk mund të caktohen në një nivel që tejkalon koston për sigurimin e dokumentit ose shërbimit (duke përfshire koston e punës dhe të materialeve dhe pajisjeve të përdorura për këtë qëllim). Ky ligj gjithashtu specifikon se të gjitha bashkëpagesat, tarifat dhe taksat për shërbimet komunale shëndetësore dhe ato arsimore janë të hyra të dedikuara të institucioneve përkatëse që i mbledhin ato.

[1]Përveç burimeve të listuara, ligji parasheh që komunat të mund të mbledhin të hyra të tjera në bazë të një ligji ose marrëveshjeje me autoritetet qendrore.

Përparësitë e financimit me anë të të hyrave vetanake qëndrojnë në atë se (i) destinacioni i tyre nuk është i caktuar paraprakisht, prandaj komuna mund t'i shfrytëzojë ato në mënyrën që konsideron se më së miri i shërben plotësimit të nevojave të popullatës së komunës; dhe (ii) për dallim prej granteve qeveritare (të diskutuara në pjesët në vijim), fondet nga këto të hyra barten në buxhetin e vitit tjetër për komunën përkatëse nëse ato nuk shfrytëzohen brenda vitit fiskal kur janë mbledhur, që do të thotë se qytetarët mund të jenë të sigurt që tatimet dhe ngarkesat komunale që ata i paguajnë do të shpenzohen në komunën e tyre.

Pjesëmarrja e të hyrave vetanake në buxhetet e komunave të Kosovës aktualisht sillet rreth 10-20% dhe brenda këtyre të hyrave kontribuuesi kryesor është tatimi në pronë. Është tipike që të hyrat vetanake shfrytëzohen për investime në infrastrukturë (p. sh., ndërtim dhe riparim rrugësh, shkollash, terrenesh sportive; ndriçim të qytetit, etj.), por edhe për pajisje të shkollave dhe bibliotekave, etj.

Rregulloret komunale mbi taksat, tarifat dhe ngarkesat, si dhe Rregulloret mbi tatimin në pronë mund të gjenden në faqet e komunave përkatëse, në të cilat mund të qaseni nga faqja http://kk.rks-gov.net/ Informatat rreth tatimit në pronë, përfshirë edhe mënyrën e harxhimit të të hyrave nga ky tatim nga ana e komunave mund të gjenden në http://tatimineprone-rks.org/

Rezultatet e investimeve të financuara në vitet e fundit me këto të hyra për secilën komunë mund të gjenden në http://tatimineprone-rks.org/al/INVESTMENTS.

Rregulloret komunale mbi taksat, tarifat dhe ngarkesat, si dhe Rregulloret mbi tatimin në pronë mund të gjenden në faqet e komunave përkatëse, në të cilat mund të qaseni nga faqja http://kk.rks-gov.net/
Informatat rreth tatimit në pronë, përfshirë edhe mënyrën e harxhimit të hyrave nga ky tatim nga ana e komunave mund të gjenden në http://tatimineprone-rks.org/
Rezultatet e investimeve të financuara në vitet e fundit me këto të hyra për secilën komunë mund të gjenden në http://tatimineprone-rks.org/al/INVESTMENTS.

Duke pasur parasysh rëndësinë e të hyrave vetanake, Kutia 1 më poshtë përmbledh disa këshilla rreth asaj se çfarë mund të bëjnë anëtarët e Kuvendit të Komunës për të ngritur nivelin e të hyrave

vetanake.

Si anëtar i Kuvendit Komunal ju mund:

Të shqyrtoni me kujdes dokumentet relevante të propozuara nga qeveritë komunale, siç janë:

- Rregullorja komunale mbi taksat, tarifat dhe ngarkesat,
- Rregullorja komunale mbi tatimin në pronë,
- Planifikimi i të hyrave vetanake të komunës.

Gjatë shqyrtimit të dokumenteve të mësipërme, me theks të veçantë të mendoni për ar-syeshmërinë dhe efektet potenciale ekonomike, p. sh, të:

- lartësisë së taksave, tarifave e ngarkesave,
- normës tatimore dhe kritereve për vlerësimin e pronës, etj.

Informoni qytetarët në baza të rregullta rreth:

- faktit se të hyrat nga tatimet dhe ngarkesat komunale që ata paguajnë medoemos do të shpenzohen në komunën e tyre,
- realizimit të projekteve të financuara nga të hyrat vetanake, në mënyrë që ata të shohin rezultate të prekshme të pagesës së tatimit,
- projekteve specifike potenciale që do të mund të financoheshin nga të hyrat vetanake nëse ata bëjnë pagesat me rregull.

Mbikëqyrni rregullisht punën e inspektorateve të komunës, me theks të veçantë në trendët e:

- përfshirjes së tatimpaguesve,
- nivelit të faturimit,
- nivelit të realizimit të të hyrave në krahasim të faturimit,
- masat që janë duke u ndërmarrë për të mbledhur borxhet, etj.

Mbikëqyrni rregullisht punën e Inspektoratit të Tatimit në Pronë, si burim kyç i të hyrave, p. sh., rreth:

- regjistrimit të pronave të reja dhe atyre ekzistuese,
- vlerësimit të drejtë të pronave dhe faturimin e tatimit,
- ushtrimit të masave për realizimin e vjeljes dhe vjeljes së detyruar të tatimit në pronë, etj.

Kutia 1: Çfarë mund të bëni për të promovuar të hyrat vetanake?

2.2 Grantet operative

2.2.1 Granti për shëndetësi parësore

Granti për shëndetësi parësore është grant me sistem të mbyllur, madhësia e të cilit bazohet në numrin e popullatës (të normalizuar) dhe standardet e vëna nga Ministria e Shëndetësisë. Normalizimi i numrit të popullatës merr parasysh strukturën moshore dhe gjinore të popullatës, si dhe numrin e personave të moshuar dhe të atyre me nevoja të veçanta shëndetësore. Për vitin 2015, përllogaritja e grantit për shëndetësi parësore është bërë siç vijon:

Mënyra e përllogaritjes dhe shumat përfundimtare të granteve operative mund të gjenden në vendimet e Komisionit të Granteve. Vendimet e këtij komisioni duhet të jenë të publikuara në faqen e Ministrisë së Financave: https://mf.rks-gov.net/sq-al/Komisioni-Granteve/Komisioni-i-Granteve/Dokumentet

Granti për shëndetësi parësore = Numri i popullatës (i normalizuar) x (2.5 Vizita për kokë banori x për Vizitë + €3.5 Shërbime për kokë banori x €3.9 për Shërbim)

2.2.2 Granti për arsim parauniversitar

Granti për arsim parauniversitar është grant me sistem të mbyllur, madhësia e të cilit bazohet në numrin e regjistruar të nxënësve dhe standardet e siguruara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Formula e këtij granti gjithashtu merr parasysh programin mësimor kombëtar, arsimin për nxënës me nevoja të veçanta, shpenzimet operative (përveç pagave), si dhe madhësinë standarde të klasës. Për nxënësit e pakicave etnike dhe për shkollat e viseve malore ndahet financim mesatarisht më i lartë për nxënës, duke pasur parasysh numrin e vogël të klasave (dhe rrjedhimisht raportin më të lartë nxënës-mësimdhënës). Përllogaritja e grantit për arsim parauniversitar është bërë siç vijon:

Granti për arsim parauniversitar = Pagat e mësimdhënësve + Pagat e personelit ndihmës dhe administrativ + Mallrat dhe shërbimet + Shpenzimet kapitale

2.2.3 Granti i përgjithshëm

Me qëllim të financimit të kompetencave të tjera komunale, Ligji për financat e pushtetit lokal parasheh një grant të përgjithshëm me sistem të mbyllur (do të thotë, të kufizuar). Ky grant duhet të përbëjë 10% të të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore (do të thotë, pa të hyrat vetanake të komunave), duke përjashtuar: (i) të hyrat nga shitja e pasurive, (ii) të hyrat e tjera të jashtëzakonshme, (iii) të hyrat e dedikuara dhe (iv) të hyrat nga huamarrja.

Ndarja e këtij granti në mes komunave ka për qëllim të sigurojë stabilitetin e të hyrave komunale, të promovojë barazinë ndërmjet komunave, si dhe të mundësojë qasje në shërbime publike për secilën komunë dhe për komunitetet pakicë në komunat përkatëse.

Prandaj, ndarja e këtij granti në mes komunave bazohet në disa kritere:

- Më qëllim të balancimit të dallimeve në kapacitetin e mbledhjes së të hyrave vetanake mes komunave (do të thotë, disavantazhin e komunave të vogla), secilës komunë fillimisht i ndahet një shumë vjetore paushall prej €140,000 në vit minus €1 për kokë banori.

- Shuma e mbetur më pas ndahet në mes komunave individuale bazuar në disa kritere:
  - 89% sipas popullatës së përgjithshme;
  - 3% sipas numrit të popullsisë pakicë;
  - 2% për komunat, shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare;
  - 6% sipas përmasave gjeografike të komunave.

Për dallim prej granteve për shëndetësi dhe arsim, të cilat ndahen në mënyrë specifike për këto shërbime, mënyra e shpenzimit të grantit të përgjithshëm është në diskrecion të vetë komunës.

2.3 Burimet e tjera të financimit

Transferet për kompetencat e deleguara janë transfere nga ministritë përkatëse te komunat për të ushtruar funksionet e deleguara nga niveli qendror:

- Shënimet kadastrale;
- Regjistrimi civil;
- Regjistrimin i votuesve;
- Regjistrimi i biznesit dhe licencimi;
- Distribuimi i pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve); dhe
- Mbrojta e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës dhe dhënia e licencave për prerjen e drunjve.

Grantet për kompetencat e shtuara janë grante që u jepen komunave të cilave me Ligjin për vetëqeverisje lokale u janë dhënë kompetenca *të shtuara* vetanake:

- Për komunat e Mitrovicës së Veriut, Graçanicës dhe Shtërpcës: kompetencat e zgjeruara për ofrimin e përkujdesit dytësor shëndetësor, përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të përkujdesit shëndetësor, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e personelit dhe administratorëve.
- Për Komunën e Mitrovicës së Veriut: kompetencat për shkollimin universitar, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve shkollore, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve arsimorë.
- Për të gjitha komunat ku komuniteti serb është shumicë: kompetenca për të ushtruar përgjegjësitë për çështjet kulturore dhe të drejta të zgjeruara për pjesëmarrje në zgjedhjen e komandantëve të stacioneve policore lokale.

Këto grante janë të veçanta nga granti i përgjithshëm dhe, ngjashëm me grantet për shëndetësi dhe arsim, ndahen vetëm për kompetencat e shtuara dhe nuk mund të shpenzohen për aktivitete të tjera.
Grantet e jashtëzakonshme u ndahen komunave në raste të jashtëzakonshme në rast të ndodhive që kanë ndikim serioz në komunë (siç janë fatkeqësitë natyrore) për të ndihmuar komunën të përballojë financiarisht këto raste.
Huamarrja si formë e financimit të investimeve të komunës është e lejuar me Ligjin për financat e pushtetit lokal. Ky ligj më tej vë disa kufizime rreth huamarrjes nga ana e komunës, të tilla si: komunës nuk i lejohet të financohet nga borxhi ndërkombëtar, shuma e borxhit duhet të jetë e mbuluar

nga kolaterali në pronësi të komunës dhe nuk mund të kalojë 50% të hyrave vetanake të komunës gjatë vitit të kaluar, etj. Kërkesa për huamarrje nga ana e komunës duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës dhe të autorizohet nga Ministri i Financave.

Ndihma financiare nga Republika e Serbisë është e lejuar sipas Ligjit për financat e pushtetit lokal dhe Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Ky i fundit i përcakton ndihmat financiare të komunës nga Republika e Serbisë si të ardhura të dedikuara të asaj komune dhe obligon komunat që këto t'i shfrytëzojnë vetëm për qëllime që ndërlidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e kompetencave të tyre komunale. Këto të hyra duhet të depozitohen në një llogari zyrtare bankare në pajtim me kërkesat e përcaktuara në LMFPP ose në një llogari në një bankë komerciale të çertifikuar Banka Qendrore e Kosovës. Në rast se ndihma financiare depozitohet në një bankë komerciale, ajo duhet të regjistrohet nga ana e komunës në Regjistrin Kontabël të Thesarit në përputhje me Rregullat për Kontrollin dhe Menaxhimin Financiar. Ndihma financiare nga Republika e Serbisë nuk ndikon në madhësinë e granteve qeveritare të komunës.

3. Procesi i planifikimit të buxhetit komunal

Planifikimi i buxhetit komunal bëhet në kuadër të një kalendari mjaft dinamik dhe të ndërlikuar. Në këtë proces përfshihen institucione të pushtetit qendror sikurse Kuvendi i Kosovës, Qeveria dhe Ministria e Financave dhe institucione të pushtetit lokal si Kryetari dhe Kuvendi i Komunës. Pjesë e pashmangshme e procesit të planifikimit të buxhetit komunal janë edhe vetë qytetarët e komunave përkatëse.



Figura 6: Procesi i planifikimit të buxhetit komunal

Kalendari i planifikimit të buxhetit komunal ofron drejtim dhe strukturë uniforme për procesin buxhetor dhe ofron qartësi për të gjithë pjesëmarrësit e procesit rreth asaj se çfarë të pritet dhe çfarë kërkohet nga ata në secilin hap të procesit buxhetor. Ky proces ofron specifikat (afatet, veprimet, përgjegjësitë) që duhet të respektohen nga secila palë e përfshirë në proces për të menaxhuar dhe marrë pjesë në procesin buxhetor dhe, në të njëjtën kohë, ofron vijimësi dhe përqendron vëmendjen në përmbushjen e kërkesave metodologjike dhe procedurale.

Dinamizmi i procesit të planifikimit të buxhetit shprehet përmes angazhimit të vazhdueshëm të organizatave buxhetore për të përmbushur në mënyrë efektive përgjegjësitë e caktuara që rrjedhin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Ato duhet të kenë proces të vazhdueshëm të planifikimit, buxhetimit dhe vlerësimit. Prandaj, organizatat buxhetore duhet të fillojnë planifikimin për buxhetin e tyre vjetor sa më herët që është e mundur në vitin përkatës.

Pikë fillestare e procesit të planifikimit të buxhetit konsiderohet data **30 prill**, data para së cilës **Qeveria e Kosovës ia dorëzon Kuvendit të Kosovës Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve**. Gjatë kësaj periudhe mbahen **mbledhjet e Komisionit të Granteve** dhe përcaktohen kornizat e përgjithshme të planifikimit të buxhetit komunal. Më tej, Ministria e Financave është e obliguar që deri më datën 15 maj të nxjerrë **Qarkoren buxhetore të 1-rë**. Më tej, deri më 30 qershor, komuna duhet t`ia dorëzojë Ministrisë së Financave **Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB)** të miratuar nga Kuvendi i Komunës.

Ekzistojnë dy lloje të qarkoreve buxhetore:

- Qarkoret buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave;
- Qarkoret buxhetore të brendshme të komunave.



Figura 7: Hapat që duhen ndërmarrë gjatë planifikimit të buxhetit komunal

Procesi i planifikimit të buxhetit komunal vazhdon me dorëzimin nga ana e ZKF-së tek secili departament komunal i **Qarkores së 1-rë buxhetore të brendshme komunale** përmes së cilës u kërkohet departamenteve apo drejtorive komunale përgatitja e propozimeve buxhetore dhe dorëzimi i tyre tek ZKF. Më tej, ZKF departamenteve ua dorëzon **Qarkoren e 2-të buxhetore të brendshme komunale** e cila përmban informata dhe udhëzime mbi kufijtë e shpenzimeve dhe **Qarkoren e 3-të buxhetore të brendshme komunale** e cila përmban orarin për organizimin e dëgjimeve buxhetore.

Ministria e Financave jo më vonë se me 15 gusht nxjerr **Qarkoren e 2-të buxhetore** që ofron udhëzimet përfundimtare buxhetore dhe nivelet përfundimtare të granteve.



Figura 8: Përfshirja e Kuvendit të Komunës në procesin e buxhetimit

Kryetari i Komunës është i obliguar që pas miratimit të tij, deri më datë 1 shtator, t`ia dorëzojë Kuvendit të Komunës **projekt-buxhetin për vitin e ardhshëm. Kuvendi i Komunës deri më 30 shtator duhet të miratojë dhe t`ia dorëzojë Ministrisë së Financave buxhetin komunal për vitin e ardhshëm.**

Procesi i planifikimit të buxhetit vazhdon më tej me procedura të tjera të cilat realizohen në **Qeveri**, e cila pas miratimit të projekt-buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe projektligjit për ndarje buxhetore,**ia dorëzon këto dokumente Kuvendit të Kosovës jo më vonë se më 31 tetor të atij viti** fiskal.

Më tej, **Kuvendi i Kosovës** përmes procedurave të veçanta **miraton buxhetin** për vitin e ardhshëm fiskal **deri më datën 31 dhjetor.**

Krahas të gjitha këtyre procedurave dhe afateve kohore, si pasojë e planifikimit joadekuat të buxhetit, ndodh procesi i rishikimit të buxhetit. Vendimi për ndërmarrjen e një veprimi të tillë, si dhe afati kohor për realizimin e tij, bëhet me udhëzime të veçanta të Ministrisë së Financave.

3.1 Përfshirja e Kuvendit të Komunës në planifikimin e buxhetit komunal

Nga kjo që u tha më sipër, në shikim të parë mund të arrihet deri tek konstatimi se Kuvendi i Komunës nuk ka ndonjë rol qenësor në procesin e planifikimit të buxhetit komunal dhe se ai përfshihet në këtë proces vetëm përmes miratimit që duhet ta bëjë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (deri më datë 30 qershor) dhe të buxhetit komunal (deri më 30 shtator).

Përfshirja e Kuvendit të Komunës dhe të anëtarëve të tij edhe në fazat e tjera të këtij procesi është e një rëndësie të madhe për tre arsye themelore:

E para: Anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të kenë informata të hollësishme jo vetëm rreth versioneve përfundimtare të dokumentit të KAB-it dhe të buxhetit komunal, por edhe rreth hollësive të gjithë procesit, pasiqë secili hap i procesit të planifikimit të buxhetit komunal ka ndikim të madh në gjithë procesin si tërësi.

E dyta: Afati kohor prej 30 ditësh në mes të datës 1 shtator dhe datës 30 shtator nuk është i mjaftueshëm për anëtarët e Kuvendit të Komunës që të sigurohen se projekt-buxheti i pranuar nga Kryetari i Komunës është në përputhje me kërkesat e qytetarëve të komunës.

E treta: Anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të jenë pjesë e gjithë ciklit të planifikimit të buxhetit. Për të siguruar një gjë të tillë, Kuvendi i Komunës duhet të kërkojë trajtimin e materialeve dhe dokumenteve buxhetore në mekanizmat e saj. Në këtë kontekst, Kuvendi i Komunës duhet ta ftojë Zyrtarin Kryesor Financiar në afatet përkatëse që anëtarëve të Kuvendit të Komunës t'u japë informata mbi:

- Qarkoren e 1-rë buxhetore të Ministrisë së Financave;
- Qarkoren buxhetore komunale të 1-rë;
- Qarkoren buxhetore komunale të 2-të;
- Qarkoren buxhetore komunale të 3-të; dhe
- Qarkoren e 2-të buxhetore të Ministrisë së Financave.

Në të njëjtën kohë, anëtarët e Kuvendit të Komunës këto dokumente mund t'i gjejnë në Ministrinë e Financave dhe në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa të komunës së tyre.



Figura 9: Përmbajtja e dokumenteve të planifikimit të buxhetit komunal

3.2 Dokumentet komunale të cilat duhet të trajtohen gjatë planifikimit të buxhetit

Gjatë procesit të planifikimit të buxhetit komunal, anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të analizojnë dhe shqyrtojnë dokumentet e miratuara po nga kuvendi. Kjo bëhet me qëllim të identifikimit të veprimeve të parapara në dokumentet në fjalë që kanë implikime financiare për komunën. Si të tilla, veprimet në fjalë dhe kostoja financiare për zbatimin e tyre duhet të trajtohen në buxhetin komunal. Në të kundërtën, dokumenti i miratuar nga ana e Kuvendit të Komunës dhe veprimet e parapara në të mbeten të pa trajtuara dhe të parealizuara.
Dokumentet të cilat duhet të shqyrtohen në këtë fazë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës janë:

- Planet zhvillimore komunale dhe urbane;
- Planet rregullative;
- Strategjitë e ndryshme sektoriale (p.sh. për arsim, riatdhesim, riintegrim të komuniteteve, etj.);
- Planet e veprimit (p.sh. për transparencë, rini, etj.);
- Rregulloret komunale, etj.



Figura 10: Dokumentet që duhet të trajtohen gjatë planifikimit të buxhetit komunal

4. Buxhetimi i targetuar, me pjesëmarrje dhe transparent

4.1 Buxhetimi i targetuar

Buxhetimi i targetuar paraqet konceptin e buxhetimit i cili merr për bazë nevojat specifike të grupeve të caktuara dhe të margjinalizuara të shoqërisë. Përmes këtij koncepti synohet trajtimi i problemeve specifike përmes intervenimit të posaçëm për zbutjen apo zgjidhjen e atyre problemeve.

Nevojat specifike të personave me nevoja të veçanta mund të merren si një nga shembujt e buxhetimit të targetuar. Ndërtimi i pjerrtësive në trotuare, mundësimi i qasjes së personave me nevoja të veçanta në objektet e institucioneve publike, shenjat e posaçme në trotuare për personat e verbër dhe shumë shembuj të tjerë mund të përmenden në këtë kontekst.

Buxhetimi i targetuar mund të zbatohet edhe për shumë grupe të tjera me rëndësi të posaçme për komunën, për trajtim të problemeve në mjedis dhe shumë fusha të tjera. Ky koncept mund të zbatohet për gratë, për të rinjtë, të moshuarit, etj. Koncepti i buxhetimit të targetuar nuk nënkupton domosdoshmërisht ndarjen e mjeteve financiare të drejtpërdrejta për ndonjërin nga këto grupe. Ajo më shumë ka të bëjë me analizën e nevojave specifike të grupeve të caktuara të shoqërisë gjatë realizimit të projekteve specifike të financuara nga buxheti komunal.

Disa shembuj:

- Gjatë ndërtimit të trotuareve duhet të merren parasysh nevojat e personave me aftësi të kufizuara, të të verbërve, të moshuarve, etj.
- Gjatë ndërtimit të shkollave, ambulancave apo objekteve të tjera të natyrës publike, duhet të ndërtohen pjerrtësi të posaçme për të mundësuar qasjen e personave me aftësi të kufizuara.
- Gjatë identifikimit të projekteve për investime kapitale duhet të trajtohen si prioritare eliminimi i rreziqeve të mundshme të cilat mund të rrezikojnë jetën e qytetarëve (p. sh., nga vërshimet, rrëshqitja e dheut, shtretërit e lumenjve, ndotja e ajrit, etj).

E rëndësishme në kuadër të konceptit të buxhetimit të targetuar është planifikimi i saktë i nevojave për adresimin e problemit, planifikimi i saktë i aktiviteteve që duhet të ndërmerren me qëllim të trajtimit dhe evitimit të problemit, identifikimi i saktë i kostos financiare të nevojshme për realizimin e aktiviteteve, si dhe avokimi. Adresa për avokim të mëtejmë mund të jenë Kryetari i Komunës, drejtori kompetent për fushën përkatëse, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, komitetet e kuvendit apo edhe vetë anëtarët e Kuvendit të Komunës, por edhe institucionet e nivelit qendror.

4.2 Buxhetimi me pjesëmarrje

Buxhetimi me pjesëmarrje është koncept komplementar i buxhetimit të targetuar sepse nuk mund të flasim për buxhetim të targetuar pa buxhetim me pjesëmarrje. Me pjesëmarrje në këtë kontekst nënkuptohet pjesëmarrja e grupeve dhe kategorive të ndryshme të shoqërisë në procesin e planifikimit të buxhetit. Fundja, si mund t`i kuptojmë nevojat e grupeve të ndryshme të shoqërisë pa i përfshirë ata në procesin e planifikimit të buxhetit.

Zbatimi i mirëfilltë i konceptit të buxhetimit me pjesëmarrje kërkon ndërmarrjen e disa veprimeve të autoriteteve të komunës, ku roli i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në realizimin e atyre veprimeve mund të jetë shumë domethënës. Buxhetimi me pjesëmarrje duhet të realizohet në fazën e organizimit të dëgjimeve buxhetore me publikun. Andaj, që kjo fazë të jetë e suksesshme në kuptim të përfshirjes të sa më shumë qytetarëve në procesin e planifikimit të buxhetit, dëgjimet duhet të organizohen me grupe të ndryshme të qytetarëve dhe atë në:

- Zona urbane dhe rurale të komunës;
- Hapësira të përshtatshme për qytetarët;
- Kohë të përshtatshme për qytetarët.

Rëndësi të madhe në organizimin me sukses të dëgjimeve ka edhe njoftimi me kohë i qytetarëve, përmes kanaleve të ndryshme të informimit, për mbajtjen e dëgjimeve publike, si dhe përgatitja dhe publikimi i raporteve nga këto dëgjime. Roli i anëtarit të Kuvendit të Komunës është mjaft i rëndësishëm në të gjitha këto faza dhe atë përmes monitorimit të zbatimit të këtyre parimeve dhe ushtrimit të trysnisë publike dhe politike tek zyrtarët kompetentë për zbatimin e tyre.

4.3 Buxhetimi transparent

Buxhetimi transparent ka të bëjë me lejimin e qasjes së publikut në të gjitha fazat e buxhetimit, duke përfshirë fazën e planifikimit, por edhe të realizimit të buxhetit komunal. Në këtë kontekst, rëndësi të madhe ka publikimi, të paktën në faqen elektronike të komunës, i të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë me fazën e planifikimit të buxhetit komunal. Krahas kësaj, jetike për buxhetimin transparent është edhe publikimi i raporteve periodike mbi realizimin e buxhetit komunal.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës kanë rol të rëndësishëm edhe në procesin e buxhetimit transparent. Ky rol buron nga fakti se ata mund dhe do të duhej të mbikëqyrnin publikimin e dokumenteve në fjalë në faqen elektronike të komunës, si dhe njëkohësisht të ushtrojnë trysninë e tyre publike dhe politike për këtë qëllim.
Parimet e buxhetimit të mirë të cilat duhet t'i ketë parasysh çdo komunë janë:

- Respektimi i kornizës ligjore,
- Investimet kapitale sipas kërkesave të qytetarëve,
- Transparenca,
- Pjesëmarrja e qytetarëve në planifikim,
- Llogaridhënia,
- Zbatimi i suksesshëm i buxhetit,
- Auditimi i rregullt,
- Vlerësimi i performancës dhe,
- Qëndrueshmëria.

Transparenca në procesin e hartimit të buxhetit, sikurse edhe në procesin e realizimit të buxhetit komunal, ka ndikim të madh në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj komunës. Transparenca në procesin e planifikimit të buxhetit do të ndikojë, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, në përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në komunë. Përmes këtij procesi, ata do të kenë mundësi që, së paku, të njoftohen me planet dhe përparësitë e komunës, si dhe do të kenë mundësi t'i paraqesin rekomandimet dhe kërkesat e tyre. Kjo do të rrisë në mënyrë të drejtpërdrejtë cilësinë e buxhetit komunal, si dhe ndikimin e tij në trajtimin e brengave dhe kërkesave të qytetarëve.

Transparenca në procesin e realizimit të buxhetit komunal, nga ana tjetër, shërben si mjet për informimin e qytetarëve rreth burimeve të financimit të komunës, si dhe rreth kategorive dhe shumave të shpenzuara nga ana e komunës. Këto informata e bëjnë qytetarin pjesë të proceseve që zhvillohen në komunë dhe i shërbejnë rritjes së llogaridhënies së udhëheqësisë komunale karshi qytetarëve.

5. Prokurimi

5.1 Institucionet rregullative

Institucionet të cilat e rregullojnë prokurimin publik në Republikën e Kosovës janë:

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) është agjenci e pavarur rregullatore e themeluar sipas Ligjit për prokurim publik (Nr. 04/L-042). Kryetari dhe anëtarët e KRPP-së propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi me mandat pesëvjeçar. KRPP është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) është autoritet i themeluar sipas Ligjit për prokurim publik. AQP-ja administrohet nga një drejtor me mandat trevjeçar. AQP-ja mund të përcaktohet nga Ministri për Financa si organ kontraktues për kryerjen e një prokurimi të caktuar për shkak të ekspertizës profesionale, efektivitetit të kostos apo efiçiencës. Sipas propozimit të Ministrit për Financa, Qeveria e vendos një listë të mallrave që kanë përdorim të përbashkët, prokurimi i të cilave i caktohet AQP-së. Komuna mund të caktojë AQP-në për kryerjen e një aktiviteti prokurimi në emër të saj ose mund të kërkojë nga AQP-ja t'i ndihmojë asaj për kryerjen e një aktiviteti të prokurimit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) është organ i pavarur për shqyrtim administrativ, i cili përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar për një mandat pesëvjeçar. Kryetari dhe anëtarët e OSHP-së propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi në bazë të rekomandimit të bërë nga një organ përzgjedhës i pavarur i themeluar nga Kuvendi. OSHP-ja është përgjegjëse për zbatimin e procedurave për shqyrtimin e prokurimit sipas Ligjit për prokurim publik.

5.2 Procesi i prokurimit

Sipas Ligjit për prokurim publik, të gjitha prokurimet publike duhet të realizohen sipas parimeve në vijim:

- **Ekonomizimi dhe efikasiteti** - komuna është e obliguar që të garantojë që fondet dhe burimet publike të përdoren në mënyrë më ekonomike, njëkohësisht duke marrë parasysh qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
- **Trajtimi i barabartë / Jo-diskriminimi** – komuna duhet t'i trajtojë të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, si dhe të veprojë në mënyrë transparente.

Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe, në qoftë se vlerësimi i nevojave e arsyeton ushtrimin e aktivitetit të prokurimit, Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) duhet të sigurohet se ka mjete financiare në dispozicion për prokurimin përkatës, në shumë të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve që mund të dalin si rezultat i prokurimit në fjalë gjatë vitit aktual. Për çdo aktivitet të prokurimit të komunës, ZKA-ja duhet të caktojë një person që të shërbejë si Zyrtar Autorizues për atë aktivitet të prokurimit
Procesi i prokurimit publik përbëhet nga 8 hapa kryesorë:

Planifikimi i prokurimit - Jo më pak se gjashtëdhjetë ditë para fillimit të çdo viti fiskal, komuna duhet të përgatitë dhe të dorëzojë në AQP planin paraprak të prokurimit, ku përfshihen të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët të cilat komuna planifikon t'i prokurojë gjatë vitit fiskal. Ky planifikim mundëson që të saktësohet vlera e përgjithshme e llogaritur e prokurimit sipas lëmisë së secilit produkt dhe shërbim, të cilin komuna planifikon që ta prokurojë gjatë vitit fiskal; si dhe, në rastin e kontratave për punë, veçoritë thelbësore të çdo kontrate të punës që komuna planifikon ta japë gjatë vitit fiskal. Brenda 15 ditëve pas shpalljes së miratimit të buxhetit për vitin fiskal, komuna duhet të përgatitë dhe të dorëzojë në AQP planin përfundimtar të prokurimit.

Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës është hapi i dytë në procesin e prokurimit. Vlera e parashikuar e një kontrate publike duhet të parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Parallogaritja e tillë duhet të jetë realiste dhe e arsyeshme për kontratën e parashikuar nga aspekti i efikasitetit, efektivitetit të kostos dhe përdorimit transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike.

Përcaktimi i procedurës së prokurimit është hapi i tretë në procesin e prokurimit. Si kriter kryesor për përcaktimin e procedurës së prokurimit përdoret vlera e parashikuar e kërkesës. Përveç kësaj, edhe rrethanat e kërkesës mund të përdoren si kritere shtesë për përcaktimin e procedurës së prokurimit. Llojet e procedurave të prokurimit janë të prezantuara në pjesën 6.3.

Përgatitja e dosjes së tenderit paraqet hapin e katërt në procesin e prokurimit. Për secilën kontratë të parashikuar apo konkurs të projektimit duhet të krijohet një dosje e tenderit, përveç nëse kontrata është me vlerë minimale. Dosjet e tenderëve dhe dosjet e konkursit të projektimit përgatiten duke përdorur formularët standardë përkatës të miratuar nga KRPP. Struktura e dosjes së tenderit përbëhet nga tre pjesë kryesore: informata për tenderuesit; projekt-kontrata; dhe formulari i tenderit.

Figura 11: Procesi i prokurimit në Kosovë

Publikimi është hapi i pestë në procesin e prokurimit dhe përbën njërin prej mekanizmave kyç për garantimin e transparencës. Ekzistojnë 5 lloje të njoftimeve: njoftimi paraprak; njoftimi për kontratë; njoftimi për dhënie të kontratës; njoftimi për anulim; dhe njoftimi për anulim të dhënies së kontratës.

Hapja dhe vlerësimi i tenderëve paraqet hapin e gjashtë në procesin e prokurimit. Tenderët e pranuar hapen vetëm publikisht. Komuna duhet të specifikojë në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit vendin dhe kohën e hapjes së tenderëve. Hapja e tenderëve bëhet nga zyrtari përkatës i prokurimit, i cili duhet të lexojë me zë emrin dhe vendin e tenderuesit, si dhe çmimin e përgjithshëm të tenderit. Komuna duhet ta themelojë një komision vlerësues për vlerësimin e ofertave.

Dhënia e kontratës i bëhet operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët ose tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kritereve dhe peshës që është specifikuar në dosjen e tenderit.

Monitorimi i kontratës, sipas Ligjit për prokurim publik, bëhet nga KRPP-ja. Menaxhimi i kontratës fillon kur nënshkruhet kontrata dhe vazhdon deri pas skadimit të garancioneve. KRPP-ja monitoron nëse kontrata është zbatuar në përputhje me kushtet e kontratës.

5.3 Procedurat për parashtrimin e ankesave

Operatorët ekonomikë ose tenderues të dëmtuar nga ndonjë vendim i Autoritetit Kontraktues (komunës) kanë të drejtë ankese. Ankesa për procedurat e prokurimeve duhet të dorëzohet në OSHP brenda dhjetë ditëve pas datës së pranimit të njoftimit mbi dhënien e kontratës përkatëse ose njofti-

mit për rezultatet e konkursit. Nëse OSHP-ja e konstaton se ankesa është parashtruar me kohë dhe është e plote, atëherë Kryetari i OSHP-së, me propozimin e Kreut të Sekretariatit, e autorizon një ekspert shqyrtues nga Njësia e Shqyrtimit të ankesave, si dhe e formon Panelin Shqyrtues për të shqyrtuar procesin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të përfshira në ankesë. Eksperti shqyrtues, pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të prokurimit në fjalë, duhet të japë një vlerësim me shkrim për aktivitetin e prokurimit. Brenda 4 ditëve pas marrjes së vendimit nga OSHP-ja, komuna duhet t'i dërgojë ekspertit shqyrtues, panelit shqyrtues dhe parashtruesit të ankesës vendimin e saj për çështjet e parashtruara në ankesë. Jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë pas skadimit të afatit kohor të përcaktuar me ligj, OSHP-ja duhet të marrë vendimin e saj përfundimtar me shkrim, së bashku me një deklaratë me shkrim mbi arsyet faktike dhe ligjore për të cilat është marrë një vendim i tillë, si dhe ndonjë urdhri që nevojitet për zbatimin e vendimit të tillë.

5.4 Llojet e procedurave të prokurimit

Procedurat e hapura duhet të zbatohen nga komuna gjatë realizimit të aktiviteteve që kanë për qëllim dhënien e një kontrate publike, përveç nëse me dispozita ligjore autorizohet përdorimi i procedurave të tjera të prokurimit. Veçori e procedurës së hapur është se kushdo, pavarësisht kualifikimit dhe kapacitetit, mund të tenderojë për kontratë.

Procedurat e kufizuara janë procedura të prokurimit në të cilat të gjithë operatorët ekonomikë mund të kërkojnë të marrin pjesë dhe ku vetëm operatorët ekonomikë të ftuar nga Autoriteti Kontraktues mund të dorëzojnë një tender.

Procedurat e negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës për të kryer aktivitetin e prokurimit mund të përdoren nga komuna në raste të veçanta, në qoftë se për arsye të natyrës së disa shërbimeve të sigurimeve, bankare dhe të investimeve, të menaxhmentit, të konsulencës apo shërbimeve të tjera intelektuale është e pamundur të përgatiten specifikacionet e kontratës në mënyrë që të lejojnë dhënien e kontratës duke zgjedhur tenderin më të mirë sipas rregullave që drejtojnë procedurat e hapura ose të kufizuara, apo në qoftë se natyra e shërbimeve ose rreziqet që përcjellin ato nuk lejojnë caktimin paraprak të çmimit të përgjithshëm.

Procedurat e negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës mund të përdoren nga komuna për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien e çfarëdo kontrate publike nëse: për arsye objektive dhe të detyrueshme teknike ose artistike, kontrata duhet t'i jepet një operatori të caktuar ekonomik; për arsye të mbrojtjes së të drejtave të pronës intelektuale apo industriale apo të drejtave ekskluzive, kontrata mund t'i jepet vetëm një operatori të caktuar ekonomik; ka emergjenca të jashtëzakonshme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen nga komuna.
Procedurat për kuotimin e çmimeve mund të përdoren për të ushtruar një aktivitet të prokurimit që ka për qëllim dhënien e një kontrate të punimeve, mallrave ose shërbimeve me vlerë minimale ose të vogël, në qoftë se kontratat për punë përfshijnë vetëm merremetim apo mirëmbajtje, ose, në rast të mallrave ose shërbimeve, mallrat ose shërbimet përkatëse aktualisht janë në dispozicion të komunës, mallrat ose shërbimet përkatëse nuk kanë nevojë që të prodhohen ose përpunohen posaçërisht në mënyrë që t'i përmbushin kërkesat e komunës apo në rast se ekziston vetëm një treg për mallrat ose shërbimet e tilla.

Procedurat për kontratat me vlerë minimale mund të përdoren për çdo kontratë publike, vlera e përllogaritur e së cilës është më pak se 1,000 euro. Me dhënien e porosive për blerje në lidhje me prokurimin me vlerë minimale, komuna duhet të sigurojë një konkurrim efektiv, transparencë dhe efektivitet të lartë të përdorimit të fondeve publike.

5.5 Plani i rrjedhës së parasë

Plani i rrjedhës se parasë përmban informata për kohën e planifikuar të zotimit të fondeve dhe të shpenzimeve. Thesari e lejon alokimin e fondeve vetëm në bazë të planit të shpenzimeve dhe zotimeve. Brenda tridhjetë ditëve pas miratimit të Ligjit për buxhetin të Republikës së Kosovës, komuna duhet të përgatitë dhe të dorëzojë në Thesar planin e rrjedhës së parasë së gatshme, të shpërndarë përgjatë vitit fiskal, sipas nën-programeve dhe kategorive ekonomike të shpenzimeve. Plani i rrjedhës së parasë së gatshme për kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale duhet të paraqitet nga komuna në mënyrë të hollësishëm për secilin projekt kapital. Përgatitja e rrjedhës së parasë së gatshme për kategorinë ekonomike të pagave dhe mëditjeve duhet të bëhet bazuar në dinamikën e planifikuar të punësimit për secilin muaj, duke respektuar numrin e miratuar të punonjësve dhe ndarjet buxhetore për secilin nën-program sipas Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës. Planifikimi i rrjedhës së parasë së gatshme për kategoritë ekonomike: mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, si dhe shpenzime kapitale duhet të bëhet sipas planifikimit përkatës për zotimin dhe shpenzimin e fondeve.

Duke u nisur nga problemet e shumta që ndërlidhen me procesin e prokurimit në përgjithësi, si dhe me investimet kapitale në veçanti, të cilat janë ngritur vazhdimisht edhe nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, si dhe duke pasur parasysh që një përqindje e lartë e buxhetit komunal shpenzohet për investime kapitale (për vitin 2014, sipas Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës, 33% e buxhetit të komunave është ndarë për investime kapitale).

Më poshtë janë dhënë disa këshilla rreth asaj se çfarë mund të bëjnë anëtarët e Kuvendit të Komunës për të përmirësuar cilësinë e procesit të prokurimit në përgjithësi:

- Të sigurohen që Komiteti për Politikë dhe Financa të shqyrtojë planin vjetor të prokurimit, në pajtim me kërkesat e Ligjit për vetëqeverisje lokale;
- Të sigurohen që buxheti, posaçërisht ai për investimet kapitale, të realizohet sipas planit, duke pasur parasysh që realizimi i ulët i buxhetit rezulton në financimin apo ngarkimin e buxhetit të vitit të ardhshëm me projektet e vitit aktual, si dhe mbingarkesa e një periudhe me vëllim të madh të punës rrit rrezikun e lëshimeve gjatë aktiviteteve të prokurimit dhe kryerjes së pagesave;
- Të sigurohen që procedurat e prokurimit në komunë janë në pajtim me kërkesat e Ligjit për prokurim publik, si dhe të akteve të tjera nën-ligjore përkatëse;
- Të sigurohen që të respektohen kriteret e vendosura nga komunat në dosjet e tenderëve;
- Të kërkojnë raporte të përditësuara për statusin e investimeve kapitale, në mënyrë që të identifikohen vonesat në realizimin e projekteve sipas afateve të parapara me kontratë dhe, në raste të tilla, të ndërmerren masat e nevojshme;
- Të sigurohen që pagesat ndaj operatorëve ekonomikë të kryhen me rregull.

Ligji Nr. 04/L-042 për prokurim publik në Republikën e Kosovës, si dhe Ligji Nr. 04/L-237 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurim publik mund të gjenden në ueb-faqen e Kuvendit të Kosovës http://www.kuvendikosoves.org

si dhe në ueb-faqen e KRPP-së: https://krpp.rks-gov.net/

Rregullorja Nr. 03/2014 për alokimin e fondeve
mund të gjendet në ueb-faqen e Ministrisë së Financave: https://mf.rks-gov.net/sq-al/

Udhëzimet administrative për prokurimin publik mund të gjenden në ueb-faqen e KRPP-së: https://krpp.rks-gov.net/

6. Monitorimi dhe mbikëqyrja e buxhetit komunal

Monitorimi dhe mbikëqyrja e buxhetit komunal realizohet përmes tre shtyllave kryesore. Shtylla e parë dhe më e rëndësishmja është se Kuvendi i Komunës është organi më i lartë i pushtetit lokal dhe njëkohësisht, organi mbikëqyrës i autorizuar ligjërisht për sigurimin e ofrimit të shërbimeve nga ekzekutivi i komunës. Shtylla e dytë mbikëqyrëse është audtimi i brendshëm, përgjegjës për rishikimin e shpenzimeve dhe minimizimin e mundësive për mashtrim dhe keqpërdorim fondesh. Së fundi, shtylla e tretë mbikëqyrëse përbëhet nga auditimi i jashtëm i cili realizohet nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Pjesa në vijim prezanton rolin e Kuvendit të Komunës në monitorimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit komunal, kurse pjesa 9 prezanton rolin e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në monitorimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit komunal.

6.1 Roli i Kuvendit të Komunës në mbikëqyrjen e buxhetit

Kuvendi i Komunës është i autorizuar ligjërisht të përdorë mekanizma të ndryshëm për ushtrimin e rolit të tij në monitorimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit komunal. Njëri ndër mekanizmat kryesorë është raportimi financiar që bëhet nga Kryetari i Komunës. Përveç kësaj, Kuvendi i Komunës mund të shfrytëzojë edhe mekanizma të tjerë të cilat janë paraqitur në Figurën 12 më poshtë.



Figura 12: Roli i Kuvendit të Komunës në monitorimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit komunal

Raportimi financiar, si njëri ndër mekanizmat kryesorë të monitorimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit komunal, ka për qëllim informimin objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit përkatës rreth përmbushjes se planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes se obligimeve të planifikuara sipas plan-programeve, dinamikës së mjeteve të shpenzuara sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhës së parasë, si dhe tregues të tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e

përgjithshme për periudhën për të cilën raportohet. Raportet financiare përgatiten në përputhje me SNKSP (Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik) të bazuar në para të gatshme, që do të thotë se transaksionet dhe ngjarjet njihen vetëm kur komuna pranon apo paguan para. Komuna i raporton të gjitha transaksionet përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit, pasi që ajo nuk operon me llogari bankare. Qeveria e Republikës së Kosovës udhëheq dhe menaxhon shpenzimet dhe të hyrat e të gjitha organizatave buxhetore përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit. Pasi të bëhet miratimi i pagesave nga komuna, thesari u transferon përfituesve pagesat në emër të komunës.

Në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e neneve 45.4, 46.1 dhe 46.2 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Kryetari i Komunës duhet t'i dorëzojë Kuvendit të Komunës këto raporte tremujore:

Raporti mbi të ardhurat dhe shpenzimet	Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve faktike
	Diskutimi per respektimin e kufirit të deficitit, përfshirë shkaqet e devijimeve dhe financimin e deficiteve nëse ka të tillë, apo shkaqet e suficiteve buxhetore dhe investimin e atyre suficiteve, nëse ka të tillë
	Të ardhurat faktike të komunës, të identifikuara sipas llojit, të krahasuara me parashikimet përkatëse të cilat janë përfshirë në buxhet
	Shpenzimet faktike për secilën kategori të shpenzimeve, krahasuar me ndarjen buxhetore për atë kategori dhe shpenzimin faktik për atë kategori gjatë vitit të kaluar kalendarik
	Të ardhurat e përkufizuara faktike të pranuara, të identifikuara sipas llojit, si dhe shpenzimet faktike, sipas klasifikimit, nga ndarjet buxhetore për të ardhurat e dedikuara
	Numri faktik i punonjësve të përhershëm dhe të përkohshëm të komunës krahasuar me numrat e autorizuar në buxhet
	Pagesat faktike të interesit ose shumave në natyrën e interesit në borxh, si dhe për pagimin e shumës kapitale të borxhit
	Hollësi rreth shpenzimeve nga ndarjet buxhetore për shpenzime të jashtëzakonshme
	Hollësi rreth modifikimeve që janë bërë në ndarje buxhetore
Të dhënat mbi investimet dhe detyrimet	Hollësi lidhur me investimet e parave publike të cilat janë kryer gjatë vitit fiskal
	Hollësi mbi ndonjë detyrim të përshkruar në nenet 50 ose 51 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë
	Llogaritja e plotë e aseteve, e cila realizohet nga organizatat buxhetore në fund të vitit fiskal
	Vlerësimi i të gjitha detyrimeve kontingjente, duke përfshirë vlerësimin e riskut të këtyre detyrimeve kontigjente
	Të gjitha shpenzimet e vonuara
	Plani për diskutim të përshtatjeve fiskale për të kompensuar deficitin e tepruar apo për të ri-vendosur kufirin e deficitit pas rritjes së atij kufiri
Të dhënat mbi investimet kapitale	Përmbledhje e gjendjes së të gjitha projekteve kapitale te investimeve
Raporti mbi gjetjet e auditorit	Një raport mbi veprimet e ndërmarra dhe veprimet e propozuara në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit te Përgjithshëm në raportin vjetor të auditimit të pasqyrave financiare

Figura 13: Përmbajtja e raporteve tremujore financiare

Gjatë shqyrtimit të raporteve financiare, anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet t'i kushtojnë rëndësi të posaçme identifikimit të mospërputhjeve ndërmjet planifikimit dhe realizimit të buxhetit (mospërputhjet nënkuptojnë tejkalimin e buxhetit ose mosrealizimin e planit dinamik).

Raporti mbi pranimet dhe pagesat përfshin totalin e të ardhurave dhe shpenzimeve në para të gatshme, të ndara sipas kategorive ekonomike. Në përputhje me SNKSP-në, në rastet kur entiteti raportues nuk i kontrollon paratë e gatshme, ky raport paraqet burimet e fondeve dhe mënyrën e shfrytëzimit të fondeve. Shuma që paraqitet si burim i fondeve është shuma aktuale e shpenzimeve të bëra përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit dhe paraqet burimin e fondeve të shpenzuara. Për secilën gjë të raportuar në raportin mbi të ardhurat dhe shpenzimet jepen edhe shpjegime më të hollësishme. Këto shpjegime mund të gjenden duke iu referuar numrave pranë secilës kategori ekonomike në raport.

Raporti i ekzekutimit të buxhetit jep të dhëna rreth buxhetit fillestar sipas Ligjit për buxhetin, reth buxhetit përfundimtar sipas Sistemit Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK), rreth realizimit të buxhetit, si dhe rreth krahasimit të buxhetit përfundimtar me realizimin. Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Ligji për ndarjet buxhetore lejojnë përshtatje buxhetore gjatë vitit. Përshtatjet që lejohen përfshijnë të hyrat vetanake të bartura nga vitet e kaluara, transferet e autorizuara ndërmjet programeve dhe ndryshimet në buxhetin e miratuar me rishikimin e gjysmëvitit. Më poshtë është dhënë një shembull i raportit të ekzekutimit të buxhetit.

Shpalosja e detyrimeve (faturave të papaguara të komunës) kërkohet nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Komuna duhet t'i raportojë të gjitha detyrimet që i ka në fund të periudhës raportuese, duke përfshirë të gjitha faturat e papaguara dhe detyrimet kontingjente. Komunës nuk i lejohet të marrë përsipër detyrime gjatë vitit aktual fiskal në shuma që i tejkalojnë fondet e ndara. Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe tejkalimi i buxhetit mund të rezultojë në mos-përmbushjen e objektivave të organizatës dhe në pamundësinë për të financuar detyrimet e vitit aktual. Gjithashtu, tejkalimi i afatit prej 30 ditëve kalendarike në pagesa nuk përputhet me kërkesat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Kuvendi i Komunës në mbledhjet e tij duhet të kërkojë raporte të hollësishme të faturave të papaguara, të identifikojë faturat të cilat e kane kaluar afatin 30 ditor të pagesës, të kërkojë sqarime nga Kryetari i Komunës, si dhe të ndërmarrë hapa të tjerë të nevojshëm për sigurimin e pagesës së faturave.

Shpalosja e pasurive të komunës është kërkesë e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Komuna duhet t'i shpalosë të gjitha pasuritë të cilat i ka në pronësi në fund të periudhës raportuese. Raportet për pasuritë që duhet të paraqiten nga komuna janë:

- Pasqyra e pasurive jofinanciare kapitale, jokapitale dhe stoqeve;
- Pasqyra e llogarive të arkëtueshmeve; dhe
- Pasqyra e avanseve të paarsyetuara.

Duke marrë parasysh që shumica e komunave në Kosovë kanë probleme me saktësinë e listës së pasurive, çështja që është ngritur vazhdimisht edhe në raportet e auditimit të jashtëm është se Kuvendi i Komunës duhet t'i kushtojë rëndësi të posaçme raportit të pasurive. Ai duhet të kërkojë nga ekzekutivi që t'i japë lista të përditësuara të pasurive komunale dhe të kërkojë nga komuna që të caktojë burime shtesë për regjistrimin, kontrollimin dhe vlerësimin e aseteve të komunës, si dhe të sigurohet që në

mënyrë të vazhdueshme të bëhet regjistrimi dhe prezantimi i pasurive në pasqyra financiare. Në anën tjetër, komuna duhet të mbajë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara dhe të painkasuara. Llogaritë e arkëtueshme duhet të shpalosen në pasqyrat financiare në tabelën përkatëse sipas llojit të të hyrave. Gjithashtu ato rregullisht duhet të përditësohen dhe rishikohen të dhënat rreth pagesave nga palët e treta, shumave të llogarive të arkëtueshmeve dhe detyrimeve kontingjente, për të garantuar saktësinë dhe plotësinë e shpalosjeve të tilla në pasqyrat financiare.

Bilanci i të hyrave vetanake të pashpenzuara të organizatës buxhetore duhet të raportohet nga komuna sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Komuna duhet të raportojë shumën e të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak, të mbledhura gjatë vitit fiskal, që kanë qenë në dispozicion për shpenzim gjatë periudhës së raportimit. Bilanci i pashpenzuar duhet të shpaloset në tabelë.

Shpalosja e ndryshimeve buxhetore gjatë vitit fiskal është kërkesë e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Buxheti i miratuar në fillim të vitit për organizatat buxhetore mund të pësojë ndryshime në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Këto ndryshime duhet të paraqiten në pasqyrat financiare në formën e një analize të ndryshimeve ndërmjet buxhetit fillestar dhe përfundimtar sipas kategorive ekonomike.

Raporti i numrit të punonjësve brenda komunës duhet të raportohet nga komuna, si dhe ndryshimet e këtij numri gjatë vitit fiskal. Numri i punonjësve duhet të raportohet sipas programeve të komunës. Raporti i veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të auditimit paraprak përbën pjesën e fundit që duhet të shpaloset në raport financiar sipas kërkesave të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Raporti i veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të auditimit paraprak përbën pjesën e fundit që duhet të shpaloset në raport financiar sipas kërkesave të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.
Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm të Kuvendit të Komunës në monitorimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit komunal, anëtarët e Kuvendit të Komunës mund të:

Ligjet përkatëse mund të gjenden në ueb-faqen e Kuvendit të Republikës së Kosovës: http://www.kuvendikosoves.org

Rregullorja Nr. 03/2013 për pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore mund të gjendet në ueb-faqen e Ministrisë së Financave: https://mf.rks-gov.net

- Kërkojnë përditësime të rregullta rreth procesit të përgatitjes dhe ekzekutimit të buxhetit komunal dhe të buxheteve për projekte të ndryshme të investimeve kapitale;
- Kërkojnë raporte financiare të hollësishme në vend të atyre përgjithësuese të cilat nuk përmbajnë të dhënat e nevojshme për gjykim të drejtë;
- Sigurohen që deklaratat financiare për kontratat kornizë për mallra dhe shërbime, si dhe për investime kapitale, të jenë të hollësishme dhe të përfshijnë buxhetin e planifikuar për çdo projekt, shumën për të cilën është kontraktuar projekti, si dhe shumën për të cilën është kryer projekti. Për të siguruar transparencë në monitorimin e buxhetit komunal, vlera e punëve të kryera nga kontraktori (shuma në përfundim të projektit) duhet të përfshijë ndaras edhe ndryshimin në vlerën përfundimtare si rezultat i ndryshimeve të kushteve të projektit pas dhënies së kontratës.

7. Auditimi

7.1 Auditimi i brendshëm

Roli i auditimit të brendshëm është që të garantojë në mënyrë të pavarur që menaxhimi i riskut, qeverisja dhe kontrollet e brendshme të një organizate janë duke operuar në mënyrë efektive. Në bazë të Ligjit nr. 02/L-74 për auditimin e brendshëm, secila organizatë buxhetore duhet ta themelojë njësinë e auditimit të brendshëm dhe të sigurojë që veprimtaritë, shënimet si dhe sistemet e saj të menaxhimit dhe kontrollit t'i nënshtrohen së paku një herë në vit një auditimi të brendshëm gjithëpërfshirës. Qëllimi i këtyre auditimeve është përcaktimi i nivelit të zbatueshmërisë së ligjeve, rregulloreve dhe akteve të tjera nën-ligjore relevante. Auditimi i brendshëm u ndihmon subjekteve të sektorit publik duke:

- Vlerësuar pajtueshmërinë me ligjet, rregulloret, rregullat e brendshme dhe kontratat, për të qenë të përgjegjshëm ndaj publikut;
- Identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar rreziqet;
- Vlerësuar besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacioneve financiare dhe informacioneve të tjera;
- Vlerësuar efikasitetin, efektivitetin dhe ekonomizimin e operacioneve;
- Minimizuar mundësitë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim fondesh; dhe,
- Dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimeve.



Figura 14: Cikli i auditimit të brendshëm dhe roli i Kuvendit të Komunës

Të gjithë auditorët duhet ta kryejnë punën e tyre sipas këtyre parimeve:

Ligjshmëria - Auditimet duhet të jenë në pajtim të plotë me ligjin, rregullat, standardet dhe praktikat e zbatueshme;

Integriteti - Auditimet duhet të bëhen në mënyrë profesionale dhe sipas të gjitha kushteve të zbatueshme ligjore. Auditorët duhet të shmangin konfliktin e interesave dhe nuk duhet të lejojnë që çështjet personale të çfarëdo lloji të ndikojnë në auditimet që ata i kryejnë;

Paanësia dhe objektiviteti - Auditimet duhet të kryhen me nivel të lartë profesionalizmi. Ata duhet të nxjerrin përfundime në bazë të testimeve dhe vlerësimeve të balancuara duke mos lejuar që puna e tyre të ndikohet në çfarëdo mënyre nga interesat e tyre personale ose interesat e ndonjë personi tjetër;

Fshehtësia profesionale/Konfidencialiteti - Auditorët duhet të respektojnë vlerat dhe pronësinë e informatave që i pranojnë dhe nuk duhet t'i zbulojnë informatat para cilitdo person, përveç nëse kërkohet në mënyrë specifike me ligj;

Kompetenca - Secili auditor duhet të ketë dhe përdorë njohuritë, aftësitë dhe përvojën e nevojshme për zbatimin profesional të auditimit;

Pavarësia - Auditorët janë të pavarur nga aktivitetet që auditohen dhe personat përgjegjës ose të përfshirë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në aktivitetet e tilla.

7.2 Auditimi i jashtëm

7.2.1 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Shkalla e tretë e mbikëqyrjes së buxhetit komunal realizohet nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm përbëhet nga Auditori i Përgjithshëm dhe personeli i zyrës së auditimit. Auditori i Përgjithshëm emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat pesëvjeçar. Ai duhet t'i ketë kualifikimet dhe veçoritë e domosdoshme për kryerjen e punës së tij (të ketë nivel të lartë morali, të jetë i paanshëm dhe i ndershëm). Auditori i Përgjithshëm ka liri të plotë veprimi në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tij apo të saj. Përderisa auditimi i brendshëm kryen auditime brenda komunës dhe është përgjegjës ndaj qeverisë, Auditori i Përgjithshëm ka mandat për të audituar të gjitha organizatat buxhetore dhe subjektet e tjera në Kosovë të cilat janë më shumë se 50% në pronësi publike ose marrin mjete financiare nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, sigurojnë dividendët apo të ardhura të tjera të pataksueshme për të. Auditori i Përgjithshëm është përgjegjës ndaj Kuvendit të Republikës së Kosovës. Deri më 31 gusht të çdo viti, Auditori i Përgjithshëm i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës mbi auditimet e realizuara për çdo entitet të audituar. Raportet e auditimeve vihen në dispozicion të publikut. Auditori i Përgjithshëm ka të drejtë të angazhojë persona, subjekte apo organizata ndërkombëtare për të ndihmuar në realizimin e auditimeve. Ai mund të delegojë tërësisht auditime të entiteteve, me kusht që personi, organizata ose subjekti të cilit i bartet ky funksion të jetë në përputhje me të gjitha udhëzimet ligjore të Auditorit të Përgjithshëm.

7.2.2 Përkufizimi i auditimit të jashtëm

Auditimi i jashtëm është kontroll i pavarur i pasqyrave financiare të një entiteti, qëllimi i të cilit është dhënia e një opinioni lidhur me atë se a japin pasqyrat financiare pamjen e vërtetë dhe të drejtë të aspektit financiar të operacioneve për periudhën raportuese, si dhe a janë ato në pajtueshmëri me standardet raportuese të kontabilitetit dhe standardet financiare të adaptuara.

Format e opinioneve mbi pasqyrat financiare sipas përkufizimeve të ISSAI 200[2] janë këto:

- **Opinioni i kualifikuar**

Kur auditori nuk është dakord ose është i pasigurt nëse një ose më shumë elemente të veçanta të pasqyrave financiare janë të lira nga anomalitë;

- **Opinion i kundërt**

Kur efekti i një gabimi është shumë material dhe i përhapur në pasqyrat financiare, saqë nuk mund të bëhet kualifikimi i raportit;

- **Mohim i opinionit**

Kur auditori nuk është në gjendje të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare të marra në tërësi, për shkak të një pasigurie apo një kufizimi të qëllimit, thelbësor ose gjithëpërfshirës;

- **Opinioni i pakualifikuar**

Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale për sa vijon:

- Nuk ka anomali materiale;
- Pasqyrat janë në përputhje me kërkesat statusore dhe rregulloret përkatëse;
- Pasqyrat financiare përmbajnë shpalosjet e duhura të informacionit për të gjitha çështjet materiale;

- **Theksi i çështjes**

Tërheqja e vëmendjes së lexuesit për një çështje të shpalosur në pasqyrat financiare. Theksimi i një paragrafi të çështjes nuk ndikon opinionin e auditorit.

Për dhënien e një opinioni të caktuar për pasqyrat financiare, auditorët duhet:

- Të vlerësojnë rrezikun;
- Të bëjnë planifikimin e procedurave të auditimit;
- Të kryejnë procedurat e auditimit;
- Të vlerësojnë rezultatet;
- Të shprehin opinionin.

Përveç raportit të auditimit ku shprehet opinioni i auditorëve mbi pasqyrat financiare, auditorët e jashtëm duhet që, në pajtim me standardet e raportimit, të përgatitin letrën përfundimtare të menaxhmentit për entitetin e audituar. Letra e menaxhmentit është një raport që përfshin të gjitha përfundimet që i kanë nxjerrë auditorët e jashtëm në lidhje me aktivitetin apo gjendjen financiare të entitetit të audituar, informatat në lidhje me realizimin e raportimit financiar, si dhe një deklaratë specifike për sistemin e kontrolleve të brendshme. Për më tepër, letra e menaxhmentit përmban gjetjet specifike që kanë rezultuar nga auditimi, ndikimin e atyre gjetjeve në aktivitetet e komunës, rrezikun që rrjedh prej tyre, rekomandimet për trajtimin e tyre, si dhe komentet e menaxhmentit për gjetjet në fjalë. Pas përfundimit të auditimit dhe marrjes së raportit dhe të letrës se menaxhmentit, komuna duhet të ndërmarrë masa për të trajtuar rekomandimet e auditorëve të jashtëm. Ajo duhet të caktojë një plan veprimi për secilën gjetje të auditorëve. Plani i veprimit duhet të përfshijë strategjitë e zgjedhura për të adresuar rekomandimet dhe gjetjet, afatin kohor për zbatimin dhe treguesit që do të përdoren për të identifikuar zbatimin e suksesshëm.

[2] ISSAI apo standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit lëshohen nga Organizata ndërkombëtare e institucioneve supreme të auditimit (INTOSAI).

Adresimi i rekomandimeve, qoftë atyre nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, qoftë nga angazhimi i auditorëve të pavarur, është në nivelin ende të ulët në të gjitha komunat e Kosovës. Nga një numër i madh i rekomandimeve të konstatuara në 38 komuna të Kosovës, vetëm afërsisht 1/3 e tyre janë adresuar plotësisht dhe vetëm më pak se 1/3 janë adresuar pjesërisht.

Duke pasur parasysh rëndësinë e auditimit të jashtëm si dhe të gjetjeve të auditorëve të jashtëm, më poshtë janë dhënë disa këshilla se çka mund të bëjnë anëtarët e Kuvendit të Komunës për ta rritur efikasitetin e auditimit të jashtëm në komunë:

- Gjatë procesit të auditimit, në rast se anëtarët e Kuvendit të Komunës janë në dijeni të ndonjë problemi apo çështjeje që mund të jetë në interes të punës së auditorëve të jashtëm, të kërkojnë takime me auditorët dhe t'i ngrisin këto çështje para tyre;
- Anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të sigurohen që për secilën gjetje të auditorëve të jashtëm të ketë një plan veprimi i cili përmban në vete strategjinë e vendosur, personin përgjegjës dhe afatin kohor për adresimin e gjetjes;
- Te sigurohen që planet e veprimeve të zbatohen brenda afateve kohore të vendosura.

Raportet e auditimit të jashtëm mund të gjenden:

- Tek Zyra e Kryetarit të Komunës;
- Në Zyrën e Njësisë së Auditimit në Komunë;
- Tek Komitetit i Auditimit;

Pas publikimit nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, në ueb-faqen e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm: http://www.oag-rks.org/

Raportet e Auditimit të Brendshëm mund të gjenden:

- Në Zyrën e Njësisë së Auditimit në Komunë;
- Tek Komitetit i Auditimit;

Ligji Nr. 03/L-128 për auditimin e brendshëm mund të gjendet në ueb-faqen e Kuvendit të Republikës së Kosovës: http://www.kuvendikosoves.org/

Ligji 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës mund të gjendet në ueb-faqen e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm: http://www.oag-rks.org/

7.3 Përshkrimi i punës në grupe

Pyetje	Përgjegje
• Si mund të ndikojë Kuvendi i Komunës në rritjen e të hyrave vetanake?	Të hyrat vetanake të komunës janë të hyra të cilat drejtpërdrejt ndikojnë në numrin e projekteve për investime kapitale që do të realizohen në komunë. Sa më të larta të jenë të hyrat vetanake, aq më shumë projekte kapitale mund të realizohen në atë komunë. Në këtë kuptim, Kuvendi i Komunës, si organ përfaqësues i qytetarëve, mund të ketë rol dhe ndikim të madh në rritjen e të hyrave vetanake të komunës. Anëtarët e grupit duhet t'i identifikojnë veprimet e mundshme të cilat duhet të ndërmerren nga Kuvendi i Komunës e të cilat do të ndikonin në rritjen e të hyrave vetanake të komunës.
• Si mund ta mbikëqyrë Kuvendi i Komunës grumbullimin e të hyrave vetanake?	Në shkallën e grumbullimit të hyrave vetanake të një komune ndikim të madh ka vetë procesi i monitorimit dhe kontrollit të grumbullimit të këtyre të hyrave. Mbikëqyrja dhe kontrolli i afërt i procesit të grumbullimit të hyrave vetanake do të ndikojë në rritjen e disiplinës së administratës komunale, duke ndikuar kështu edhe në ngritjen e nivelit të grumbullimit të të hyrave vetanake të komunës. Anëtarët e grupit duhet t'i identifikojnë mënyrat e ushtrimit të mbikëqyrjes dhe kontrollit ndaj efikasitetit të ekzekutivit të komunës në grumbullimin e të hyrave vetanake të komunës.
• Cilat janë veprimet të cilat duhet të ndërmerren me qëllim të rritjes së të hyrave vetanake?	Duke e pasur parasysh rolin dhe ndikimin e të hyrave vetanake në zhvillimin dhe realizimin e investimeve publike, komunat mund dhe duhet të ndërmarrin veprime konkrete me qëllim të rritjes së të hyrave vetanake. Praktikat e ndryshme ndërkombëtare dhe vendore ofrojnë shumë modele dhe veprime të cilat ndikojnë në rritjen e këtyre të hyrave. Anëtarët e grupit duhet t'i identifikojnë veprimet konkrete, realizimi i të cilave do të mundësojë rritjen e të hyrave vetanake të komunës.
Dita e II-të	
• Prioritizo 5 projekte të investimeve kapitale që janë në interes të Kuvendit të Komunës për tre vjet.	Anëtarët e kuvendeve të komunave sfidohen në vazhdimësi nga numri i lartë i kërkesave të qytetarëve për trajtimin e problemeve, shqetësimeve dhe kërkesave të tyre. Komunat nuk kanë mundësi reale financiare të trajtimit të të gjitha këtyre preokupimeve të qytetarëve gjatë një viti fiskal. Kështu, kuvendet e komunave detyrohen që t'i prioritizojnë këto kërkesa dhe t'i japin përparësi zgjidhjes së situatave më të rënda. Anëtarët e grupit duhet t'i identifikojnë 5 projekte të investimit kapital të cilat do të adresohen. Shuma e përgjithshme në dispozicion është 600.000 Euro. Kërkesat janë: meremetimi i çatisë së shkollës 200.000 Euro, ndërtimi i kanalizimit të një fshati 100.000 Euro, ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në një lagje 250.000 Euro, heqja e pikave të zeza në njërën nga rrugët kryesore 150.000 Euro, ndërtimi i QMF-së në fshatin më të madh 300.000 euro, ndërtimi i infrastrukturës në zonën industriale 350.000 Euro.

• Planifiko mëditjet për KPF, Komitetin për Shërbime Publike dhe Grupin e Grave për tre vjet.	Kuvendi i Komunës në vazhdimësi ballafaqohet me mungesë të mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të nevojshme për funksionimin normal të tij dhe të organeve të kuvendit. Shumë prej komiteteve të cilat i themelon kuvendi mbeten jofunksionalë në pamundësi të pagesës së mëditjeve të anëtarëve të këtyre komiteteve apo të organeve të tjera të Kuvendit të Komunës. Në shumicën e rasteve këto probleme dalin në pah si rezultat i mosplanifikimit të duhur të buxhetit të Kuvendit të Komunës. Anëtarët e grupit duhet t'i identifikojnë shpenzimet e nevojshme për pagesën e mëditjeve të këtyre organeve të Kuvendit të Komunës për një vit fiskal.
• Planifiko përmbushjen e nevojave të tjera të Kuvendit të Komunës.	Kuvendi i Komunës shumë pak përkujdeset për trajtimin e mungesave të tij gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të buxhetit komunal. Si pasojë, Kuvendi i Komunës nga viti në vit i trashëgon problemet e ngjashme të cilat kanë ndikim të madh në vetë cilësinë dhe efikasitetin e kuvendit. Anëtarët e grupit do t'i identifikojnë mangësitë dhe problemet me të cilat ballafaqohet Kuvendi i Komunës dhe t'i planifikojnë veprimet dhe shpenzimet e nevojshme për përmbushjen e nevojave të Kuvendit të Komunës.

Kapitulli IV

Komiteti për Shërbime Publike

1. Komiteti për Shërbime Publike

1.1 Pse të themelohet ky komitet

Pothuajse të gjitha kompetencat e komunave përfshijnë në fakt ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Parimi i subsidiaritetit, që është parim bazë i Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, kërkon që shërbimet për qytetarë të ofrohen nga niveli i qeverisjes që është më i afërt ndaj qytetarëve. Për të udhëhequr në mënyrën më të suksesshme ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, komunat themelojnë drejtori të posaçme për shërbime publike. Përmes kësaj drejtorie komunat kryesisht ushtrojnë kompetencat e tyre vetanake nga fushat e shërbimeve publike, sikurse janë infrastruktura, menaxhimi i mbeturinave, mbrojtja e mjedisit, mirëmbajtja e rrugëve dhe shumë shërbime të tjera. Por, ka edhe raste kur shërbime të caktuara publike ofrohen edhe nga drejtori të tjera apo edhe raste kur drejtoria për shërbime ndahet në disa drejtori (p. sh., Drejtoria për infrastrukturë).

Performanca e drejtorisë për shërbime e një komune në masë të madhe është përcaktuese edhe e performancës së përgjithshme të asaj komune. Andaj, është jashtëzakonisht e rëndësishme që angazhimi i drejtorisë për shërbime publike dhe i drejtorive të tjera që mund të ofrojnë shërbime publike të jetë në nivelin e duhur. Krahas angazhimit, është shumë e rëndësishme që të bëhet edhe monitorimi dhe mbikëqyrja e punës së drejtorive përkatëse. Korniza ligjore për vetëqeverisje lokale ka përcaktuar që drejtorët emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Komunës, që në një formë drejtorët e komunës i bënë këshilltarë të Kryetarit të Komunës. Në këtë kontekst, monitorimi dhe mbikëqyrja e drejtorëve të drejtorive komunale nga Kryetari i Komunës janë vendimtare për vlerësimin e angazhimit dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike.

Megjithatë, edhe Kuvendi i Komunës, si organi më i lartë i komunës, mund dhe duhet të ketë rol në monitorimin dhe mbikëqyrjen e punës së Drejtorisë për Shërbime Publike dhe të drejtorive të tjera puna e të cilave lidhet me ofrimin e shërbimeve publike. Fundja, një nga detyrat dhe kompetencat kryesore të kuvendeve të komunave është mbikëqyrja e punës së organit ekzekutiv të komunës. Andaj, sa më i lartë të jetë angazhimi i Kuvendit të Komunës në mbikëqyrjen e punës së kryetarit dhe të drejtorive të komunës, aq më e lartë është mundësia e rritjes së performancës në ushtrimin e aktiviteteve të zyrtarëve në fjalë dhe arritjes së rezultateve të kënaqshme, posaçërisht në ofrimin e shërbimeve publike.

Praktikat e avancuara parlamentare evidentojnë vështirësinë e ushtrimit të mbikëqyrjes së organit ekzekutiv nga i gjithë kuvendi, qoftë në nivel qendror apo lokal të qeverisjes. Andaj lind nevoja e themelimit të grupeve më të vogla të anëtarëve të kuvendeve të cilët rreth vetes mbledhin njohës të fushave përkatëse dhe përmes këtyre grupeve më tej ushtrojnë mbikëqyrje më të afërt dhe më cilësore të performancës së njësive të caktuara të organit ekzekutiv. Në mënyrë analogjike, kuvendet e komunave duhet të themelojnë komitete specifike për të qenë në gjendje të mbikëqyrin nga afër punën e drejtorive të komunës.

Kështu, për të qenë në gjendje të mbikëqyret nga afër ofrimi i shërbimeve publike nga Drejtoria për Shërbime Publike, Kuvendi i Komunës duhet të themelojë Komitetin për Shërbime Publike. E dëshirueshme me këtë rast do të ishte që anëtarë të këtij komiteti të jenë anëtarët e Kuvendit të Komunës që kanë përvojë dhe njohuri mbi ofrimin e shërbimeve publike. Ngjashëm me këtë shembull mund të veprohet edhe me sektorë të tjerë të komunës, sikurse janë arsimi, shëndetësia, urbanizmi, etj.

1.2 Funksionimi i Komitetit për Shërbime Publike

Sikurse në çdo organ të ngjashëm, edhe Komiteti për Shërbime Publike e zgjedh nga radhët e anëtarëve Kryesuesin e tij. Detyrë e Kryesuesit të Komitetit për Shërbime Publike është thirrja e mbledhjeve të komitetit, propozimi i rendit të ditës për mbledhje të komitetit, udhëheqja e mbledhjeve, udhëheqja e procedurës së votimit dhe përfaqësimi i Komitetit për Shërbime Publike.

Kryesuesi i Komitetit për Shërbime Publike duhet të kujdeset edhe për përmbushjen e obligimeve ligjore që lidhen kryesisht me transparencën. Kështu, ftesat për mbledhjet e këtij komiteti anëtarëve të saj duhet t'u dërgohen 7 ditë pune para mbledhjes. Paralelisht me këtë, mbi mbajtjen e mbledhjes duhet të njoftohet edhe publiku.

Në të dyja rastet, njoftimi për mbajtjen e mbledhjes duhet të përmbajë:

- Kohën e mbajtjes së mbledhjes,
- Vendin e mbajtjes së mbledhjes,
- Rendin e ditës së mbledhjes,
- Materialet e mbledhjes.

Kryesuesi i Komitetit për Shërbime Publike, në bashkëpunim me Zyrën mbështetëse të Kuvendit të Komunës dhe me Zyrën për informim publik të komunës, kujdeset për publikimin e vendimeve dhe procesverbaleve të Komitetit për Shërbime Publike në faqen elektronike të komunës, për pjesëmarrjen e qytetarëve në mbledhjet e komitetit, si dhe për organizimin e takimeve më qytetarë.

Me rëndësi për t'u përmendur janë edhe kanalet e komunikimit të qëndrimeve dhe rekomandimeve të Komitetit për Shërbime Publike. Takimet me Kryesuesin e Kuvendit të Komunës janë mekanizmi parësor të cilin duhet ta shfrytëzojnë anëtarët dhe kryesuesit e Komitetit për Shërbime Publike. Debatet në Kuvendin e Komunës, takimet me drejtoritë përkatëse, takimet me subjektet politike dhe komunikimi me mediumet janë kanale të tjera të cilat Komiteti për Shërbime Publike mund t'i shfrytëzojë me qëllim të komunikimit të qëndrimeve apo rekomandimeve të tij.

1.3 Roli i Komitetit për Shërbime Publike

Kuvendet e komunave kanë rol shumë të kufizuar në shërbimet publike, duke mos pasur mundësi që të ndikojnë në procesin e ofrimit të këtyre shërbimeve për qytetarët. Themelimi i Komitetit për Shërbime Publike i hap rrugë Kuvendit të Komunës që të rrisë ndikimin e tij në proceset që lidhen me shërbimet publike në komunë, i jep mundësi që të mbikëqyrë cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike nga komuna dhe mekanizmat e tjerë relevantë, si dhe mundëson rritje të mbikëqyrjes së zbatimit të investimeve kapitale në komunë. Përmes themelimit të Komitetit për Shërbime Publike, Kuvendit të Komunës i hapen më shumë mundësi për të komunikuar drejtpërdrejt me qytetarët dhe për të mbledhur informata rreth kërkesave, problemeve dhe rekomandimeve të qytetarëve.

Roli i Komitetit për Shërbime Publike është angazhimi për avancimin e ofrimit të shërbimeve publike në komunë. Kuvendi i Komunës, përmes këtij komiteti, duhet të japë kontributin e tij në mënyrë që qytetarëve të komunës t'u ofrohen shërbime sa më cilësore.

Në kuptim teknik, anëtarët e Komitetit për Shërbime Publike nuk janë ata të cilët i ofrojnë këto shërbime publike për qytetarët, pra ata nuk kujdesen për mirëmbajtjen e rrugëve, ndriçimin publik apo shërbime tjera. Mirëpo, Komiteti për Shërbime Publike angazhohet në dy detyra themelore: a) shqyrtimi dhe miratimi i politikave, rregulloreve dhe dokumenteve të tjera strategjike lidhur me shërbimet publike dhe b) mbikëqyrja e procesit të ofrimit të shërbimeve publike nga ekzekutivi i komunës dhe kompanitë përkatëse për ofrimin e shërbimeve publike.

Figura 15: Fushat e angazhimit të Komitetit për Shërbime Publike

a. Shqyrtimi dhe miratimi i dokumenteve lidhur me shërbimet publike

Kompetencë e Kuvendit të Komunës është shqyrtimi dhe miratimi i të gjitha planeve, rregulloreve dhe dokumenteve të tjera strategjike të komunës, duke përfshirë edhe ato nga fusha e shërbimeve publike. Detyrë e Komitetit për Shërbime publike është shqyrtimi i të gjitha këtyre dokumenteve para se ato të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës. Komiteti duhet të jetë mekanizëm ndihmës dhe udhëzues për kuvendin në tërësi mbi atë se çfarë vendimi duhet të marrë kuvendi në lidhje me atë dokument. Ky komitet duhet që, nga prizmi profesional, të japë komente dhe sugjerime mbi përmbajtjen e dokumenteve në fjalë.

Dokumentet të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në shërbimet publike të komunës dhe të cilat do të duhet të shqyrtoheshin nga Komiteti për Shërbime Publike janë:

1) Rregullorja për taksat, tarifat dhe gjobat komunale;
2) Rregullorja për mbrojtjen e mjedisit;
3) Rregullorja për shërbimet publike;
4) Rregullorja për shërbimet e varrimit;
5) Rregullorja për inspektimin veterinar;
6) Rregullorja për gjueti;
7) Rregullorja për përdorimin e gurit dhe zhavorrit;
8) Rregullorja për transportin rrugor dhe taksitë;
9) Rregullorja për transportin publik lokal;
10) Plani për menaxhimin e mbeturinave;
11) Plani për menaxhimin e emergjencave, etj.

b. Mbikëqyrja e shërbimeve publike

Kompetencë e Kuvendit të Komunës është mbikëqyrja e punës së ekzekutivit të komunës, si dhe të

kryetarit dhe drejtorive të komunës. Pjesë e kësaj mbikëqyrjeje është edhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe drejtoritë e tjera të komunës, puna e të cilave ndërlidhet me shërbimet publike (Drejtoria e Inspektoratit, Drejtoria për Infrastrukturë, Drejtoria e Financave, etj.). Pjesë e mbikëqyrjes së Komitetit për Shërbime Publike duhet të jenë edhe ndërmarrjet publike komunale apo rajonale dhe kompanitë private të cilat ofrojnë segmente të caktuara të shërbimeve publike (përfshirë menaxhimin e mbeturinave, transportin publik, ngrohjen qendrore, menaxhimin e hapësirave publike dhe të gjelbra, etj).

Një parim është shumë me rëndësi për të siguruar funksionalitetin dhe efikasitetin e Komitetit për Shërbime Publike. Puna dhe raporti i këtij komiteti me organet, institucionet dhe organizatat e tjera duhet të bazohet mbi parimin e ndërtimit të partneritetit. Rrjedhimisht, është jetik krijimi i partneritetit të Komitetit për Shërbime Publike me:

1) Kuvendin e Komunës;
2) Komitetet e tjera të Kuvendit të Komunës;
3) Kryetarin e Komunës;
4) Drejtorinë për Shërbime Publike;
5) Drejtorinë e Inspektoratit;
6) Drejtorinë e Financave;
7) Ndërmarrjet publike rajonale (dhe komunale) të;
    - **a.** Mbeturinave;
    - **b.** Ujësjellësit;
    - **c.** Ngrohjes qendrore;
    - **d.** Stacioneve të autobusëve;
    - **e.** Transportit publik, etj;
8) Subjektet politike;
9) Ministritë përgjegjëse;
10) Komisionet e Kuvendit të Kosovës;
11) Këshillat e fshatrave dhe kryetarët e fshatrave;
12) Kompanitë përfituese të tenderëve për ofrim të shërbimeve publike, etj.



Figura 16: Dokumentet të cilat duhet të shqyrtohen nga Komiteti për Shërbime Publike dhe partnerët potencialë të tij

1.4 Përshkrimi i punës në grupe

Pyetje	Përgjegje
Të bëhet identifikimi i nevojave të Komitetit për Shërbime Publike	Komiteti për Shërbime Publike në shumicën e kuvendeve të komunave është themeluar gjatë mandatit të fundit të tyre dhe këto kuvende dhe komitete janë në fazën e krijimit të një praktike të re në funksionimin e pushtetit lokal në Kosovë. Themelimi i Komitetit për Shërbime Publike është një hap tjetër drejt fuqizimit të kuvendeve të komunave. Megjithatë, për ta arsyetuar themelimin e tij, anëtarët e këtij komiteti duhet të tregojnë angazhim të shtuar për përmbushjen e obligimeve dhe synimeve të këtij komiteti. Në esencë, Komiteti për Shërbime Publike është themeluar që t'i ndihmojë kuvendit në fushën e shërbimeve publike, t'i shqyrtojë dokumentet, rregulloret dhe strategjitë nga fusha e shërbimeve publike, si dhe të mbikëqyrë punën e drejtorive komunale kompetente për ofrim të shërbimeve publike, duke i përfshirë edhe kompanitë publike dhe ato private të cilat ofrojnë shërbime publike. Ushtrimi i përgjegjësive dhe funksioneve të përmendur më lart kërkon përmbushjen e disa parakushteve pa të cilat Komiteti për Shërbime Publike e ka të vështirë t'i realizojë qëllimet. Anëtarët e grupit do t'i identifikojnë cilat janë nevojat e Komitetit për Shërbime Publike të cilat duhen plotësuar me qëllim të sigurimit të funksionimit normal dhe përmbushjes së obligimeve e synimeve të këtij komiteti.